

# GËZUAR VITIN E RI 2025!

FEDERATA SHQIPTARE E VETERANËVE TË LUFTRAVE PËR LIRI E PAVARËSI TË POPULLIT SHQIPTAR

# VETERANI

GAZETË PERIODIKE. NR. 1(438)

JANAR 2025

ÇMIMI: 30 LEKË

Drejtor: MUHARREM GJOKA; Kryeredaktor: HALIL RAMA; Zv/Kryeredaktor: SAKIP CAMI & BASHKIM HISARI; website: www.VETERANI.OBVL.ORG

## URIMI



**PRESIDENTI MOISIU, SIMBOL I PËRKUSHTIMIT NDAJ ATDHEUT**

**Tatjana PARLLAKU ÇARKAXHIU**

FAQE 2

## SHEFI I SHTABIT TË PËRGJITHSHËM

**ARBEN KINGJI MERR GRADËN GJENERALLEJTËNANT**



FAQE 4

## NDERIMI



**RRUGA "EMIN CIBAKU"**

**KËSHILLI BASHKIAK PËRJETËSON DËSHMORIN E BETEJËS SË KOLESJANIT**

Halil RAMA - Mjeshtër i Madh

FAQE 8

*Histori sukcesi në 2024 - OBVL hyn me një program ambicioz në 2025-ën*

# 2024 – OBVL REKORD

# VEPRIMTARISH KUALITATIVE

*Nga Emin Cami*

**Alfred Moisiu, jeta dhe karriera e pasur e një ushtaraku dinitoz e të talentuar**

Në historinë 112 vjeçare të Shtetit shqiptar, pa dyshim që ka një vend nderi presidenti, ministri i Mbrojtjes, drejtori dhe ushtaraku i lartë, veteran, dr. Alfred Moisiu.

**Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj**

FAQE 2

## DOSSIER

**80 - vjetori i shkolles 8 - vjeçare të Viçishtit të Dibrës**

*Nga Emin Cami*

FAQE 13

## SUPLEMENTI FJALA

### PROFILI

**"I PALODHURI SHPENDI TOPOLLAJ, SHKRIMTARI, NJERIU"**

Bajram SULEJMANI & Fatmir Minguli - Faqe 15

### LIBRI

**XHEMAL MEÇI, STOIK MES MALEVE TË PUKËS**

Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj -

Faqe 13



*Gjatë 2024, Organizata e Bashkuar e Veteranëve të LANÇ dhe Pasardhësve përmbylli me sukses programin e veprimtarive, në kuadrin e 80-vjetorit të çlirimit të Atdheut...*

*Nga Rajmonda MALEÇKA*

FAQE 16

## 556 VJETORI I VDEKJES SË HEROIT TONË KOMBËTAR

# ISMAIL KADARE: PORTRETI I SKËNDERBEUT



FAQE 9

**"TE KULLA E GJONIT" dhe "VENDLINDJA IME..."**  
Poezi nga Halil RAMA

**FOL MOJ SHPATË E SKËNDERBEUT**

Fragment poeme nga Mevlud BUCI

## 81-VJETORI

**RRUGA E LAVDISHME HEROIKE E BRIGADAVE TË V –të e VI- të SULMUESE**

FAQE 5

## KUMTESA

**DËSHMORËT E POLICISË, GURI KRYESOR I THEMELIT TË VLERAVE TË INSTITUCIONIT**

MSc. Bilbil DERVISHI

Sefer PASHA

FAQE 5

## PORTRET

**NAKO SPIRU, UDHËHEQES I LANÇ DHE NDËRTUES I SHTETIT DEMOKRATIK**

Nga Daut HOXHA

FAQE 6

## PORTRET

**NJË SHEKULL JETË E PROFESOR NEXHMEDIN MISIRIT**

Dr.Hasan DOMI

FAQE 10

## REKUIEM

**RIFAT VANI, PROMOVUESI I KULTURËS DHE DRITËS NË URAKË**

Nga Mimoza CACA

FAQE 11

## KUMTESA



Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj\*

Në historinë 112 vjeçare të Shtetit shqiptar, pa dyshim që ka një vend nderi presidenti, ministri i Mbrojtjes, drejtori dhe ushtaraku i lartë, veteran, dr. Alfred Moisiu. Ai është një nga figurat më të shquara të ushtrisë dhe të shkencës ushtarake shqiptare në fund shek. XX dhe fillim shek. XXI. Ai erdhi në ushtrinë shqiptare nga një familje intelektuale ushtarake. Babai, major Spiro Moisiu ishte një ushtarak madhor i ushtrisë shqiptare, të nisur karrierën e tij ushtarake në vitet e mbretërisë, në komandant batalioni, për të vijuar më tej në vitet e stuhishme të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare. Në këtë mjedis familjar ai ka pasur kushte për të marrë një edukatë të shëndoshë familjare dhe ushtarake, që e ka ndihmuar gjatë gjithë jetës për të patur rezultate të lartë si nxënës, student ushtarak dhe në të gjithë jetën e tij aktive në Forcat e Armatosura dhe në jetën civile. Shkollën fillore e nisi në qytetin e Fierit, ku i ati shërbente për të vijuar të mesme në Shkodër, ku u dallua për rezultate shumë të mira, për të përfunduar në gjimnazin "Qemal Stafa" në Tiranë në vitin 1945, ku mori njohuri të plota në të gjitha lëndët dhe u përgatit me formim të gjithanshëm.

Gjatë luftës, në situatat e turbullta dhe të ndërlikuara politike të vendit, në saj të ndjenjave patriotike dhe të ideve përparimtare, familja e tij u orientua shpejt dhe mori pjesë aktivisht në Lëvizjen Antifashiste Nacionalçlirimtare. Major Spiro Moisiu zgjidhet komandant i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare më 10 korrik 1943, në Kongresin e Përmetit u gardua gjeneralmajor dhe pas Çlirimit të vendit kreu detyrën e kryetarit të Shtatmadhorisë të UNÇSH.

Ndërsa Alfred Moisiu u përfshi në luftë i organizuar në rininë studentore Antifashiste dhe në mjaft aksione të zhvilluara prej saj. Me çlirimin e vendit studimet e larta Alfred Moisiu i kreu në shkollat dhe akademitë ushtarake të BS. Siç ka shkruar në kujtimet e tij, "kërkova të regjistrohem për ushtarak, por im atë ishte kundër", me arsytimin se do të ishte mirë të studioja në ndonjë degë civile, për arsye se jeta ushtarake ishte e vështirë dhe nuk dëshironte të vazhdoja rrugën e tij. Mirëpo edukata ushtarake dhe prindi kishte bërë punën e vet, gjatë rritjes ai ishte edukuar dhe familjarizuar me profesionet e prindit dhe kishte marrë virtytet më të mira. Në një farë mënyre ishte edukuar me rregullin, disiplinën, uniformën ushtarake, ishte dashuruar pas karrierës ushtarake, por dhe kishte ëndërra për të studiuar në shkollat ushtarake të BS.

Kështu, u nis për studime në Akademinë e Xhenios në BS. Filloi studimet me njohjen e rregulloreve pasi ato ishin shumë të rëndësishme për ushtrinë, sepse rregullorja rregullon gjithë marrëdhëniet ndërmjet eprorëve dhe vartësve, si dhe jetën e brendshme të reparteve ushtarake. Aty mësoi se përmbajtja e tyre mund të ndryshojnë në bazë të traditave të çdo ushtrie, por pa një rregullore, asnjë ushtri nuk mund të jetojë dhe ushtrojë veprim-

# Alfred Moisiu, jeta dhe karriera e pasur e një ushtaraku dinitoz e të talentuar



tarinë e saj në mënyrë të rregullt. Në mësimin e parë ju desh për të mësuar, shpjeguar dhe kuptuar përcaktimi dhe ndryshimin midis "gjitharmëshit" dhe "llojit të armës". Këto ishin terma të mirëfillta ushtarake dhe duhej kuptuar brendësia e problemit të tyre. Një mësim të vyer mori nga studimet ushtarake, në ruajtjen e dokumenteve të rëndësishme, sepse ato kanë rëndësi për vendimet e drejta të marra dhe të zbatuara me mjeshteri në kohën e duhur. Pra, krahas teorisë në Akademi mësoi shumë nga shembujt që jepeshin për luftën, për të rritur përfytyrimin real mbi veprimet luftarake në fushën e betejës. Falë zotërimit të shpejtë të gjuhës ruse, studimet i përfundoi me rezultate shumë të mira, shkëlqyeshëm Shkollën Ushtarake të Xhenios në Bolshevo dhe në Leningrad në vitin 1948.

Oficeri i ri Alfred Moisiu u emërua komandant toge dhe pedagog në Shkollën e Bashkuar të Oficerave. Në vitet 1948-1951 kreu detyrën e komandantit të togës dhe dhënies mësim dhe zhvillim të stërvitjes në lëndën e xhenios. Ndonëse oficer i ri, puna e tij vlerësohej, si nga kolegët, komanda, ashtu dhe nga kursantët ushtarak. Kërkesa për të qenë prezent gjatë gjithë kohës pranë togës në mënyrë që kursantët të ishin vazhdimisht nën kontroll, natyrisht që ishte një ngarkesë e përditshme shumë e madhe për kuadrin, ndërsa kërkesa për një rritje cilësie të stërvitjes, kërkonte kohë për t'u përgatitur çdo ditë. Pedagogu i ri i shtron komandës propozim për ndarje lënde midis oficerëve-pedagog, për dy togat xheniere, që kishin të njëjtin program. Komanda e vlerësoi drejt propozimin dhe u bë ndarja, ku Alfred Moisiu zhvilloi lëndët: ura ushtarake, fortifikata, rrugë ushtarake, lëndë plasese dhe shkatërrime fushore, taktike speciale dhe lëndë të tjera që kishin të bënin me përgatitjen xheniere, ndërsa kolegu jepte lëndët: punime nëntokësore, pengesa me mina, furnizim me ujë etj.

Tekstet mësimorë në vitin 1948 ishin të pakta. Oficerët e rinj u detyru-

an të përkthenin rregulloret kryesore në gjuhën shqipe. Ishte një punë e vështirë, dhe u kërkua ndihmën nga drejtuesit kryesore të Drejtorisë së Xhenios (në atë kohë Komanda e Xhenios), të cilët e përkrahën mendimin. Ngarkesa e përkthimit u nda dhe bëhej në kohën e lirë dhe pa asnjë shpërblym. Vështirësia qëndronte jo vetëm tek problemi i literaturës, por një çështje jo e vogël ishte dhe terminologjia. Nga ushtria shqiptare nuk kishin trashëguar rregulloret, por dhe përkthimet nga italishtja dhe terminologjia e saj ishte pothuajse e njëjtë.

Kërkua dhe isistua, thekson në kujtime presidenti, që gjatë përkthimit të bënim përpjekje për të përcaktuar terminologjinë në gjuhën shqipe, që nuk ishte dhe e thjeshtë për ta bërë, por me punë ia dolën.

Alfred Moisiu vijoi studimet e larta në Akademinë e Xhenios në Moskë në vitet 1952-1958, ku u diplomua përsëri me medalje të artë. Me kthimin nga studimet e larta ushtarake emërohet në drejtorinë e Xhenios në Ministrinë e Mbrojtjes. Në këto vite operacionet (stërvitjet) luftarake për repartet xheniere përgatiteshin në drejtori, si hartimi i planeve operative luftarake, detyrat e sigurimit xhenier të njësive gjitharmëse të ushtrisë, përpilimi i programeve të zhvillimit të armës së xhenios, hartimi i pjesës xheniere të planeve të stërvitjeve, pjesëmarrja në stërvitjet e ndryshme që drejtonte Drejtoria dhe Ministria e Mbrojtjes, nga stërvitjet e shtabeve, komando-shtabi me pjesëmarrje të pjesshme të trupave dhe me mjete ndërlihdjeje në terren, në stërvitje me trupa etj.

Ishte një punë tepër intensive për oficerët në drejtori pasi për çdo stërvitje bëhej hartimi i planeve për punimet fortifikuese për repartet xheniere të RKP (Rezervë e Komandës së Përgjithshme), hartimi i planit të punimeve operative për njësitë e ushtrisë, ndjekja e tyre, koordinimi i punës me Institutin e Projektimit të Ushtrisë dhe hartimi i detyrave të projektimit për të, sipas nevojave të reparteve xheniere dhe të njësive të ushtrisë. Në të gjithë

këtë veprimtari teorike dhe praktike reflektohej dhe përvoja e talenti i Alfred Moisiut. Krahas kësaj pune intensive, kërkohet dhe përgatitja e literaturës së nevojshme për punimet fortifikuese, shtabet e reparteve xheniere dhe të shtabeve xheniere të njësive gjitharmëse. Në vijim vinte dhe studimi i taktikës, i teknikës xheniere të ushtrive të huaja, i të dhënave të zbulimit për ushtritë e huaja, në mënyrë të veçantë për vendet fqinje, por dhe të dhëna për NATO-n dhe Ushtrinë Sovjetike. Ishte një kohë kur Ushtria Shqiptare kryente shumë stërvitje, nga të gjitha llojet dhe në stërvitje të ndryshme të mëdha që bënte ushtria shqiptare, gjithmonë do të ishin dhe përfaqësues të Komandës së Traktatit të Varshavës. Nisur nga zotërimi i mirë i gjuhës ruse, Alfred Moisiu shpesh i shoqëronte nga fillimi deri në përfundim të stërvitjes.

Në punë siç ka shkruar në kujtimet e tij, është udhëhequr nga lajtmotivi se "Po nuk respektoam veten, nuk ka për të na respektuar njeri". Nga praktikat dhe stërvitjet e shtabit që zhvilloheshin në mënyrë të dëndur në repartet e ushtrisë, ndaj eprorëve dhe vartësve gjithmonë ka shfaqur cilësitë e një ushtarak korrekt dhe në respekt të punës dhe të rregulloreve ushtarake. Në të gjitha stërvitjet përpunoheshin elementët e nevojshëm, të cilat duhet të njiheshin dhe të përvetësoheshin nga oficerët dhe komandantët e njësive, përparësi ju ka kushtuar elementëve të edukatës ushtarake. Kështu gjatë viteve në drejtorinë xheniere ushtaraku i lartë Alfred Moisiu ka dhënë një kontribut të vlerësuar dhe të çmuar në hartimin e planeve, të drejtimt dhe të organizimit të punës shkencore për repartet xheniere. Në korrik të vitit 1962 merr gradën ushtarake major.

Nga fundi i vitit 1966, në Ministrinë e Mbrojtjes u zbatua vendimi për qarkullimin e kuadrin. Në qarkullim u përfshi dhe Alfred Moisiu duke u caktuar komandant i Brigadës të Urave të Rënda në Kavajë. Në këtë njësi të re të Ushtrisë u udhëhoq nga parimi se komandanti nuk mendon, ai vendos! Këtë mësim e kishte marrë nga akademitë ushtarake, ku mendimet i jep shtabi dhe jo komandanti. Kështu ushtaraku, aq me tepër komandanti i brigadës i duhej të ishte shumë i prirë dhe shumë i qartë në shprehjet e tij. Këtë ja kishte mësuar shkolla, por dhe fjalori ushtarak i cili nuk pranon ujëra të tepërta, pasi në situata luftarake minutat janë shumë të çmueshme dhe koha duhet përdorur në mënyrë racionale. Por ushtria gjithmonë dhe në paqe është në luftë, pasi detyrat duheshin kryer si në luftë. Krijimi i kësaj njësie ushtarake ishte një ngjarje e shënuar për ushtrinë, por dhe një hap shumë i madh përpara për riorganizimin, reformimin dhe zhvillimin e njësive. Komandant Alfredi me kulturën e tij të gjërë dhe aftësitë ushtarake e organizative dha një kontribut të dukshëm për ngritjen dhe organizimin e brigadës. Për këtë njësi, për gjithçka, që nga fillimi, komandanti kontribuoi mëndërisht dhe fizikisht, nga kompleksi i saj deri në përgatitjen dhe sjelljen në formën e duhur të gatishmërisë luftarake, me një teknikë të panjohur, deri atëherë në ushtrinë shqiptare.

Me formimin e lartë, pasi kishte përfunduar dhe Kursin e Lartë të Shtabit të Përgjithshëm pranë Akademisë Ushtarake, me përvojën e gjithanshme të fituar në studime dhe në punë si komandant brigade, me intuitën e thellë për parashikime largpamëse, Alfred Moisiu tashmë drejtor i


(Vijon në faqen 3)

URIMI

# PRESIDENTI MOISIU, SIMBOLI PËRKUSHTIMIT NDAJ ATDHEUT



Tatjana PARLLAKU ÇARKAXHIU



GRUPI NISMËTAR PËR FORMIMIN E OBVL-së

1. Andon	Sheti
2. Ali	Butka
3. Alfred	Moisiu
4. Bedri	Shehu
5. Dashamir	Ohri
6. Delo	Balili
7. Edip	Ohri
8. Ernest	Jakova
9. Elami	Hado
10. Guri	Sheti

• "Alfred Moisiu, jeta dhe karriera e pasur e një ushtaraku dinitoz e të talentuar", nga Prof.

ALFRED MOISIU

Ish Nënkrjetar i OBVL-së dhe Ish Presidenti Republikës, i propozuar nga OBVL

Alfred Spiro Moisiu i përket një grupi familjesh qytetare të Kavajës dhe të Durrësit, ndër ato më në zë dhe të respektuara, me kulturë e njohuri deri përtej kontinentit tonë. Midis Moisiu, dallohet botërisht gjeniu i skenës teatrale Aleksander Moisiu, por jo më pak i shquar ndër këto familje ka qenë edhe babai i Alfredit, ushtaraku i lartë i ushtrisë kombëtare të paraçlirimt, i cili më pas, në vitet e Luftës së Dytë Botërore tregoi, trimëri, gusim, patriotizëm dhe aftësi të larta për organizimin dhe drejtimin e Rezistencës Antifashiste të popullit shqiptar në luftën për çlirimin e atdheut nga okupatorët e huaj. Ky ka qenë generali numër një i Ushtrisë Nacional Çlirimtare dhe komandant i Shtabit të Përgjithshëm. Spiro Moisiu.

Alfredi nën shembullin e babait, u përfshi në Lëvizjen Antifashiste Nacional Çlirimtare në moshën 15 vjeçare. Mbas çlirimt në vijim të traditës, Alfredi kreu studimet e para ushtarake në Shën Peterburg (Leningrad), ku u diplomua oficer i trupave xheniere dhe shërbeu për një kohë në këtë armë në detyra të ndryshme.

Me 14 dhjetor 2024, Instituti i Studimit të Historisë Ushtarake organizoi sesionin jubilar për jetën dhe veprën e Dr. Alfred Moisiut – ish President i RSH. Në këtë event të rëndësishëm që u organizua në sallën "Aleks Buda" të Akademisë së Shkencave, ishin të ftuar edhe drejtuesit e OBVL: Kryetarja Tatjana Parllaku Çarkaxhiu, Sekretari i Përgjithshëm Halil Rama, nënkryetarët Muharrem Gjoka e Mirjana Ohri dhe sekretaret Mimoza Kurti dhe Rajmonda Maleçka. Pas ekzekutimit të hymnit kombëtar dhe fjalës së hapjes nga Prof. dr. asoc. berndar Zottaj, sipas programit u mbajtën kumtesat:

- "Alfred Moisiu burrë shteti dhe figurë e shquar e politikës shqiptare", nga Akademik, Prof. Dr. Pëllumb Xhufi;

- Asoc. Dr. Bernard Zottaj;
- "Alfred Moisiu dhe Familja e tij në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare", nga Sali Onuzi;
- "Alfred Moisiu, pasardhës i një Familjeje të shquar atdhetare dhe kulturore", nga Botuesi Mehmet Gëzhilli;
- "Alfred Moisiu, peshonalitet i shquar i shkencës ushtarake dhe i ndërtimeve xheniere", nga Prof. Asoc. Dr. Zaho Golemi;
- "Alfred Moisiu, në fletët e arkivit të Forcave të Armatosura", nga Prof. Asoc. Dr. Teki Kurti;
- "Alfred Moisiu, për problemet e sigurisë dhe mbrojtjes", nga Skënder Bajraktari, Ish këshilltar për sigurinë dhe mbrojtjen në Presidencë....

Në emër të Kryesisë së OBVL, përshëndeti kryetarja Tatjana Parllaku Çarkaxhiu, ndërsa i dorëzoi mesazhin e urimit Presidentin Moisiu, në të cilin shkruhet:

## Alfred Moisiu, jeta dhe karriera e pasur e një ushtaraku dinitoz e të talentuar

(Vijon nga faqja 2)



Drejtorisë së Xhenios në MM dha një ndihmesë të veçantë në zgjidhjen e mjaft problemeve që qëndronin para kësaj drejtorie. Një nga problemet e rëndësishme të fillimit, për të cilin Alfred Moisiu si drejtor ishte: përpara se të fillonin punimet fortifikuese kërkoi studimin topografik dhe gjeologjik të terrenit ku do bëheshin punime fortifikuese. Më tej shtroi nevojën e organizimit dhe të përgatitjes në masë të zjarrmëtarëve ushtarët aktiv, nëpërmjet kurseve të veçanta që zhvilloheshin nga xhenierët në ushtri. Ndërsa me oficerët e këmbësorisë dhe të artilerisë që drejtonin punimet, u organizuan kurse të ndryshme për perfeksionimin e tyre. Por në të njëjtën kohë, në programet e shkollave ushtarake për oficerët e rinj u futën disiplina të lëndëve xheniere. Njëkohësisht ndryshoi dhe plankalendarin vjetor të periudhës së kryerjes të punimeve fortifikuese në ushtri. Ishte një kohë kur që nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm dhe ministri i Mbrojtjes kërkoheshin llogari për ndërtimin e tuneleve dhe të punimeve të tjera fortifikuese, sesa për çështjet e stërvitjes. Kjo situatë ndryshoi me programet në saj të përpjekjeve të drejtor Alfred Moisiut. Një problem tjetër i rëndësishëm i kësaj periudhe ishte dhe fortifikimi, pjesa profesionale, për të cilën kishte përgjegjësi të veçantë. Në studim të fortifikimit hasi në kontradiktën midis një fortifikimi solid, në

një kohë kur mbrojtja ishte e manovrueshme. Kështu që sugjeroi të shikoheshin shpenzimet e mëdha për fortifikimin e vendit në brezat e mbrojtjes së fortifikuar, të cilat lëshoheshin me lehtësi. Në Drejtorinë e Fortifikimit u punua për të ndërtuar një sistem fortifikimi me një qëndrueshmëri maksimale. U studiuan përvojat e njohur botërore të fortifikimit, shkolla të ndryshme të fortifikimit, secila me veçori të tyre, dhe u kalua në përvojën shqiptare. Në këtë kohë drejtorja përbëhej tërësisht nga oficerë të rinj, me një nivel të mirë kulture të përgjithshme dhe ushtarake, të etur për të mësuar dhe të prirë nga një shpirt gare për të dalë me rezultate më të mira se drejtoritë e tjera. Problem i rëndësishëm në detyrën e zëvendësministrit në nëntor 1980 ishin uzinat ushtarake ku u dërgua i komanduar në Mjekës të Elbasanit si drejtues i punimeve në ndërtimin e Uzinës së Barutit, që kishte mbetur prapa në raport me grafikun e miratuar. Përvoja që dha ushtaraku i lartë ishte bashkëpunimi, pasi mosbashkëpunimi kishte krijuar shqetësime dhe tendenca të theksuara për t'i lënë përgjegjësinë njeri-tjetrit.

Problemët rrodhën ndryshe dhe zëvendësministri u transferua në një njësi të Burrelit. Me që kishte qenë kuadër me përgjegjësi të lartë në ushtri, dhe rrjedhimisht ishte në dijeni të mjaft sekreteve të ushtrisë, u paralajmërua se, nëse dekonspiron do mbante përgjegjësi penale. E emruan në detyrën e shefit të xhenios të Brigadës në Burrel. Ushtaraku me përvojë, pavarësisht se shkoi në njësi me ulje në detyrën ushtarake, qëndroi dinjitoz, kështu që komanda dhe personeli oficer ruajtën respekt dhe dashamirësi.

Koha e kërkoi në detyrën e ministrit të Mbrojtjes për një periudhë të shkurtër, pasi nuk ishte pjesëtar i asnjë force politike. E pranoi detyrën sepse ushtaraku vlerësoi situatën dhe u vu në roje të Atdheut. Më tej u gjend në detyrën e këshilltarit në Ministrinë e Mbrojtjes. Kundërshtoi heqjen me ngut dhe për të zhdukur çdo shënjë të së kaluarës, vendim për ndryshimin e emblemës së ushtarakëve, për të hequr yllin nga kapela. Përsëri në detyrën e zëvendësministrit të Mbrojtjes u kujdes dhe propozoi disa

(Vijon në faqen 7)

### I dashur President Moisiu!

Në emër të kryesisë së OBVL dhe në emrin tonë personal, kemi kënaqësinë t'ju urojmë përzemërsisht ditëlindjen tuaj të 95-të.

Emri dhe personaliteti juaj është i lidhur ngushtësisht me organizatën tonë, si bashkëthemelues i saj në korrikun e vitit 1994, me grupin prej 64 personaliteteve politike të respektuara që kishin qenë drejtues të reparteve partizane, ministra, zv/ministra e deputetë, siç ishin: Dr. Ymer Dishnica, gjeneralët Rrahman Parllaku, Nexhip Vinçani, Sadik Bekteshi e Muhamet Prodan, si dhe Skënder Malindi, Edip Ohri, Kiço Ngjela, Manol Konomi, Fadil Paçrami, Maqo Çomo dhe Ernest Jakova; luftëtarët e shquara, drejtues në luftë e aktivistë të OBVL: Selfixhe Broja(Ciu), Zenepe Golemi (Ashiku), Liri Belishova, Vera Ngjela (Poiani) e disa të tjera, por fatkeqësisht të dënuara nga regjimi diktatorial i Enver Hoxhës.

Pikërisht, në emër të këtyre personaliteteve, kur politika shqiptare përjetonte krizën e rëndë pas manipulimit të zgjedhjeve parlamentare të vitit 2001 dhe komuniteti ndërkombëtar kërkonte zgjidhje oportune, gjeneral Parllaku, Liri Belishova, Skënder Malindi e Edip Ohri, duke vlerësuar rolin dhe kontributin në historinë e Shqipërisë, propozuan emrin tuaj për president konsensual. Dhe ju me vizionin tuaj perëndimor dhe përkushtimin e rrallë ndaj popullit e atdheut, keni hyrë në histori si burrë i rrallë shteti që e drejtuat atë suksesshëm dhe më mirë se të gjithë presidentët e derisotëm.

Dhe më tej, në vlerësim të rolit dhe kontributit tuaj historik, në Kuvendin e saj të 9-të kombëtar që u mbajt këtë vit me rastin e 30 vjetorit të krijimit, organizata jonë ju zgjodhi President Nderi.

Në krenohemi me Ju që në rrugëtimin historik të shtetit shqiptar, keni dhënë kontribute të shumta e të çmuara, për të cilat populli shqiptar Ju është përjetë mirënjohës.

Mesazhet që përcjellin vepra dhe kontributi juaj kanë emrin KRENARI. Krenaria ka nevojë për një truall, për një shtrat që rritet...E pikërisht në këtë shtrat keni ecur ju në rrugëtim tuaj të gjatë, me vizionin tuaj bashkëkohor, i përshtatur mirë me kohërat, si ushtarak dhe intelektual i mirëformuar dhe i zoti, që keni çarë në jetë me mençuri e sakrificë.

Ndaj dhe jeni e do të mbeteni shembull frymëzimi për shqiptarët kudo që ndodhen.

Në këtë ditëlindje tuajën jubilarë ju përcjellim urimet më të përzemërta.

Zoti ju bekoftë dhe ju dhëntë jetë sa më të gjatë....

## CEREMONIA

Ministri Vengu shprehu konsideratat më të larta për burrat dhe gratë që themeluan dhe çuan përpara Ushtrinë Shqiptare

# Shqipëria historike, 112 vjet FA, 80 vite çlirim kombëtar, 15 vite vokacion euroatlantik

• **Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralletenant Arben Kingji: Gjatë gjithë historisë së tyre, FA-të kanë reflektuar vlerat më të mira kombëtare, kanë demonstruar përkushtim, profesionalizëm, duke u transformuar dhe modernizuar vazhdimisht për të rritur kapacitetet operationale në interes të përmbushjes së misionit kushtetues dhe kontributit për paqen dhe sigurinë**

Më 4 dhjetor 2024, në 112-vjetorin e krijimit të Forcave të Armatosura dhe 80-vjetorin e Çlirimit të vendit, në ambientet e garnizonit 'Skënderbej', nga i cili kanë dalë mbi 45 mijë burra dhe gra në uniformë, u organizua një ceremoni festive. Të pranishëm në këtë ditë të shënuar ishin, ministri i Mbrojtjes Pirro Vengu, zëvendësministri Dorian Tola dhe Enkelejd Joti, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralletenant Arben Kingji, deputetë të Kuvendit, komandantë të forcave, atashetë ushtarake të akredituar në vendin tone, ish ushtarake dhe veteranë të LANÇ e pasrdhës të tyre. OB-VLP u përfaqësua nga nënkryetari kolonel Trifon Llupo dhe anëtarët e Këshillit Drejtues Kombëtar: Destan Doçi, Hasan Shehu, Adem Ajdini dhe Adem Shehi (ish-komandnat i Brig.153 të UÇK).

Trupat aktivë ishin formuar nëpër kuadrate, dhe një pjesë e arsenalit të armëve ishin dislokuar në shesh.

Ministri i Mbrojtjes e konsideroi vendimin për krijimin e Ushtrisë Kombëtare Shqiptare vetëm gjashtë ditë pas shpalljes së Pavarësisë, jo thjesht një akt administrativ, por një akt themelues të Shqipërisë moderne, duke përcaktuar mbrojtjen dhe sigurinë si një çështje me rëndësi jetike për shtetin e sapoformuar. "Nuk mund të ketë pavarësi pa vetëmbrojtje, dhe nuk mund të ketë shtet-ndërtim pa siguruar kushtet e vazhdimësisë. Në këtë kuptim, themelimi i Forcave të Armatosura ishte një akt pavarësie të cilës i bashkëngjitej dhe misioni i sovranitetit." - u shpreh ministri Vengu. Më tej, zoti Vengu shprehu konsideratat më të larta për burrat dhe gratë që themeluan dhe çuan



përpara Ushtrinë Shqiptare dhe solli në vëmendje sfidat aktuale me të cilat Forcat tona të Armatosura duhet të përballen. "Sot, 112 vite pas aktit të themelimit, 80 vite pas aktit të rezistencës, 15 vite pas aktit të konfirmimit të vokacionit tonë euro-atlantik, teksa gëzojmë të gjithë së bashku të mirat e sigurisë kolektive që ofron Aleanca më e suksesshme në historinë moderne, ndërkohë që përballlemi me kërcënime të reja, të cilat nuk janë vetëm në horizont por bëhen gjithnjë e më të prekshme, sot pra, na duhet të mendojmë për vazhdimësinë dhe për misionin, për kombin dhe aspiratat e tij. Në këto 10 vite, është bërë një punë e lavdërueshme dhe e gjithanshme për t'u forcuar, për t'u modernizuar. Por kemi ende shumë punë për të bërë. Sot, ushtarët, nënoficerët, oficerët shqiptar, janë më të përgatitur, më të mirë trajnuar e arsimuar, më të mirë pajisur, dhe më të mirë trajtuar. Në këtë kontekst, dua të shpreh mirënjohjen tonë të thellë, ndaj të gjithë aleatëve e partnerëve që kontribuuan dhe vazhdojnë të kontribuojnë në

modernizimin e Forcave tona të Armatosura", - tha ndër të tjera

ministri Vengu, i cili nuk harroi të kujtojë ushtarakët e rënë në

krye të detyrës. Nga ana e tij, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralletenant Arben Kingji tha se gjatë gjithë historisë së tyre, FA-të kanë reflektuar vlerat më të mira kombëtare, kanë demonstruar përkushtim, profesionalizëm, duke u transformuar dhe modernizuar vazhdimisht për të rritur kapacitetet operationale në interes të përmbushjes së misionit kushtetues dhe kontributit për paqen dhe sigurinë. Në përfundim të ceremonisë, Toga Ceremoniale dhe orkestra Frymore e FA-së zhvilluan një parakalim ceremonial, ndërkohë që ministri Vengu u takua me familjarë të ushtarakëve dhe nxënësit e shkollave të mesme të pranishëm në ceremoni.

Ministri Vengu i dorëzon gradën Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA të RSH

## Arben Kingji merr gradën gjeneralletenant

**E** martë, 03 dhjetor 2024 - Në një ceremoni të veçantë, shefi i Shtabit të Përgjithshëm Arben Kingji u gradua si gjeneralletenant, pas dekretit të miratuar nga presidenti i Republikës. Kjo gradë, gjeneralletenant Kingji iu dorëzua nga ministri i Mbrojtjes z. Pirro Vengu.

Në fjalën e tij përshëndetëse, ministri Vengu vlerësoi gjeneralletenant Kingjin, si një gjeneral që është ngritur në karrierë duke kaluar të gjitha etapat e nderit dhe duke shërbyer me sukses në shumë detyra të ngarkuara. Sipas ministrit Vengu, ky është edhe një moment i veçantë pasi ylli i tretë në Forcat e Armatosura është rikthyer pas gati një dekade e gjysmë. Ministri i Mbrojtjes tha se gjeneralletenant Kingji e ka merituar këtë yll të tretë. "Dikush mund ta ketë ndjekur karrierën e tij që në kohën e Afganistanit, dikush që në kohën që ka drejtuar regjimentin në Poshtë, që kur ka drejtuar Forcën Tokësore, apo kur ka mbajtur pozicione të tjera përfaqësimi në funksion të FA. Unë në këto pak muaj kam njohur një person që, së pari ka forcën e karakterit si udhërrëfyes në mbrojtje të interesave kombëtare, në mbrojtje të të gjithë interesave të ushtarakëve, të familjarëve të tyre dhe të përmirësimit të gjithanshëm dhe të modernizimit të FA." - theksoi, gjatë fjalës së tij,



ministri i Mbrojtjes.

Teksa i uroi suksese në vijim të ushtrimit të detyrave, ministri Vengu u shpreh se, gradimi i gjeneralletenant Kingji përbën edhe motivim për të gjithë ushtarakët e tjerë të karrierës, të cilët mund të arrijnë përmes dedikimit, disiplinës dhe vetëmohimit në majën e karrierës ushtarake.

"Dikush mund të thotë që sot kemi shumë gjeneralë dhe shumë pak ushtarakë. Unë nuk e besoj këtë. Unë besoj që gjeneralët dhe oficerët në përgjithësi janë kapacitet kombëtar dhe duhet t'u ofrojmë mundësinë, që qofshin aktivë apo rezervistë, të kenë një kontribut të vazhdueshëm në funksione shtetërore." - u shpreh Ministri Vengu, duke shtuar se buxheti i vitit 2025 është më domethënës i këtyre dy dekadave të fundit, që siguron që karriera ushtarake të jetë forcë tërheqëse për

shumë të rinj.

Nga ana e tij, gjeneralletenant Arben Kingji shprehu mirënjohjen për vlerësimin e bërë nga ministri i Mbrojtjes, kryeministri e presidenti, por pati edhe një falenderim për të gjithë efektivët e FA.

"Falenderim i veçantë shkon për të gjithë ushtarët, nënoficerët dhe oficerët, me të cilët kam qenë bashkë në realizmin e një sërë detyrave, duke pasur parasysh se pas viteve '90, FA kanë kaluar një sërë sfidash, etapash, procesesh, siç janë modernizimi dhe reformimi, të cilat pa ndihmën e tyre nuk do të realizohej kjo që jemi sot, institucioni më dinjitoz dhe më korrekt, në të cilin ne shërbejmë." - u shpreh shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, i cili vuri theksin edhe te vendimet e fundit të qeverisë sa i përket trajtimit më dinjitoz të të gjithë personelit të FA.



**KONFERENCA**

*Për çdo shtet dhe komb të qytetëruar dëshmorët janë lavdia e krenaria e tij*

# DËSHMORËT E POLICISË, GURI KRYESOR I THEMELIT TË VLERAVE TË INSTITUCIONIT

**MSc. Bilbil DERVISHI**  
**Sefer PASHA**

**“Dëshmorët nuk janë statistika dhe nuk maten me emra, por me vlera”. Ky ishte konkluzioni i Konferencës së X-të Shkencore të Akademisë së Sigurisë, “Policia e Shtetit në 80-vjetorin e çlirimit të atdheut, arritje dhe sfida”.**

Dëshmorët nuk janë statistika dhe nuk maten me emra, por me vlera. Megjithatë sipas statistikave, nëse llogarisim dëshmorët e Policisë së Shtetit në tetëdhjetë vitet e fundit, nga përfundimi i Luftës së II Botërore e deri më sot, do të shohim se mesatarja është më shumë se tre të rënë në vit e ndoshta edhe më shumë. Ky është një numër i lartë, por po të mendosh se ky nuk është një numër përfundimtar, atëherë, strukturat përgjegjëse shtetërore dhe jo vetëm, kanë detyrimin e madh për seriozitet më të madh për bijtë e bijat e popullit që kanë rënë në emër të ligjit. Pothuajse çdo vit shtohen emra të rinj në altarin e të rënëve të policisë, që në fakt natyra e profesionit e pranon me dhimbje edhe këtë realitet, pasi të jesh punonjës policie është në vetvete një mision fisnik, por edhe i vështirë dhe mjaft i përgjegjshëm. Këtë mision e përsërisin në heshtje brez pas brezi emrat e të rënëve në krye të detyrës. Këtë mision e mbajnë dhe transmetojnë në dekada brezat, si shenjtëri për shtetin. Përkujtimi, nderimi dhe shenjtëria e vlerave qëndron fort në unitetin institucional të misionit të Policisë së Shtetit. Të rënë ndër vite e dekada janë simbol i rregullit, ligjit, sigurisë së brendshme shqiptare, janë e vërteta për të rënë në detyrë, për ata që gjakun e tyre e derdhën për shtetin dhe në themelet e tij.

Për çdo shtet dhe komb të qytetëruar Dëshmorët janë lavdia e krenaria e tij, një ndër vlerat më të çmuara, që nderohen e respektohen nga të gjithë. Në librat e historisë, enciklopeditë e botime të ndryshme, kudo atyre ju kushtohet vëmendje e veçantë. Për ta janë shkruar e vazhdojnë të shkruhen libra, monografi e artikuj pafund, të bëhen dokumentar e filma, të krijohen e vjersha e këngë që recitohen e këndohen pa fund në festa e ditë përkujtimore, ngrihen monumente, buste, përmendore e memorialë në nderim të tyre, emrat e tyre të përjetësohen në rrugët e sheshet e qendrave të banuara, në institucione publike, shkolla etj.

Në shumë institucione, shkolla e universitete janë të shkruar me germa të arta emrat e dëshmorëve të dalë prej tyre. Po kështu edhe në reparte ushtarake, posta kufitare apo stacione policie janë të shënuar emrat e atyre ish efektivëve të tyre që kanë rënë në krye të detyrës dhe që janë shpallur dëshmor të atdheut, e disa nga këto institucione mbajnë edhe emrat e tyre.

Për nderimin e dëshmorëve në qytetet kryesore të Shqipërisë janë ndërtuar varrezat e tyre dhe në Tiranë Varrezat e Dëshmoreve të Atdheut “Nëna Shqipëri”, varreza që mbajnë statusin e “Varrezave monumentale”. Por, pavarësisht çfarë është shkruar në ligjë për nderimin e mirëmbajtjen varrezave të dëshmorëve, ndërtimin e monumenteve, bustet apo vendosjen e pllakateve në nderim të tyre, nuk është vështirë të konstatohet se mirëmbajtja e varrezave të dëshmorëve apo e veprave të artit në nderim të tyre lë shumë për të dëshiruar. Përveç faktit se në jo pak raste flitet e shkruhet kundër tyre dhe aktivitetet që zhvillohet në nderim e kujtim të veprës së tyre janë formale dhe shpesh herë të vaktës. Respekti ndaj dëshmorëve është i përbotshme, pasi kudo nëpër sheshet e kryeqyteteve dhe qyteteve të botës, shoh monumente, buste e pllakate në nderim të tyre dhe rrugë e sheshe, shkolla e institucione me emrat e tyre. Në shqiptarët e nderojmë vdekjen, si pak kush në botë. Respekti që kemi për të afërmit tanë që nuk jetojnë më, sidomos



**• Të gjithë duhet të jemi të vetëdijshme se ka vetëm një rrugë nëpër të cilën ecën historia e lirisë. Ajo është rruga e gjakut të dëshmorëve, të cilët në momentet e mëdha historike, ishin të gatshëm të falin gjakun për ardhjen e lirisë dhe ndërtimin e konsolidimin e shtetit shqiptar, pas shpalljes së Pavarësisë e gjer në ditët tona.**

atdheut”, përfshin jo vetëm shqiptarët e Republikës së Shqipërisë, por edhe ato të trojeve shqiptare dhe madje edhe shtetas të huaj që kanë dhënë jetën në mbrojtje të shtetit shqiptar, si gjeneral Telini dhe me siguri në të ardhmen do të ketë një numër të saktë të dëshmorëve.

Edhe Policia e Shtetit në kuadër të 100 vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë dhe krijimit të forcave të rendit (13 janar 1913) hartoi dhe botoi një Album mbi historikun e Policisë si edhe ngriti një muze që ndodhet në ambientet e Akademisë së Sigurisë. Në Album dhe Muze ka faqe dhe stenda që iu kushtohen dëshmorëve. Policia nuk trashëgonte ndonjë listë të veçantë për dëshmorët nga radhët e saj, por gjatë punës u gjetën disa të dhëna në Departamentin e Veteranëve dhe Dëshmorëve, në ministrinë e Mbrojtjes, për periudhën 1944 – 1989, ku u evidentuan 52 dëshmorë që fillojnë me Bajram Poshnjarin, rënë në vitin 1945 dhe mbyllet me Bashkim Tahiraj, rënë me datë 24 prill 1988 dhe në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore në ministrinë e Brendshme për periudhën 1990 e në vijim, ku evidentohen 229 të rënë në krye ose për shkak të detyrës, nga të cilët 172 të shpallur dëshmor të atdheut.

Në një vështrim të thjeshtë të listës dhe të viteve të rënies së tyre, konstatohet që për një periudhë 45 vjeçare (1944-1989) kanë humbur jetën në krye të detyrës 52 punonjës, me një mesatare prej 1.15 persona/vit, një shifër e pranueshme dhe brenda normave mesatare të shteteve më të zhvilluara dhe më të qëndrueshme të botës. Ndërkohë që duhet theksuar se ishin vitet e para të pasluftës dhe deri në vitin 1951 kishte më shumë të rënë: 1946 (7), 1947 dhe 1948 (5), 1949 (4), 1950 (5), 1951 (4), por ka edhe periudha që s’ka asnjë humbje jete si: 1965 – 1966, 1969 – 1973 (3 vite), 1974 – 1980 (7 vite), 1984 – 1987 (4 vite).

Ndërsa në periudhën 1990 – 2024 (35 vjet) janë gjithsej 229 të rënë në krye të detyrës, nga të cilët 172 dëshmor nga radhët e Policisë, që fillon me Fatmir Latifin, rënë me datë 13 maj 1990 dhe përfundon me Naim Çoban Hyska, plagosur në një atentat me 24 dhjetor 2012 dhe vdekur për shkak të plagëve me datë 30 gusht 2023, me një mesatare vjetore prej 5.05 persona/vit. Krahasuar me periudhën e mëparshme ka një dispropocion shumë të madh rreth 4.4 herë më shumë!

Gjithsej në total, për 80 vjet (1944 – 2024) kanë rënë në krye të detyrës, sipas dokumenteve që aktualisht disponohen, 281 punonjës policie, shumica e të cilëve nga shërbimet e rendit dhe të kufirit, me një mesatare vjetore prej 3,5 punonjës/vit. Sigurisht që për periudhën 1990-2024 kjo mesatare është

më e lartë, 6,5 punonjës/vit, që është gati 2 fishi i mesatares së përgjithshme. Këtu duhet thënë se në këtë periudhë përfshihet edhe shpallja e gjendjes së jashtëzakonshme, që është pothuajse gjendje luftel? Shpallja e gjendjes së jashtëzakonshme është bërë me vendim të Kuvendit Popullor dhe ka filluar nga ora 1735e datës 2 mars 1997 dhe ka vazhduar deri në orën 16 të datës 24 korrik 1997, gjithsej 145 ditë. Në këtë periudhë kanë humbur jetën 41 punonjës policie, duke filluar nga oficeri Gjergj Mehmeti, që në ditën e dytë të gjendjes së jashtëzakonshme, me 3 mars në Sarandë dhe i fundit Fran Murrizi, me 23 korrik në Shkodër, me një mesatare një rënë në 2 në javë. Ndërsa gjatë këtij viti të mbrapsht kanë humbur jetën gjithsej 60 punonjës policie, duke filluar me Shezai Zanaj, me 12 shkurt në Vlorë dhe përfunduar me Ismet Laçin, me 31 dhjetor në Pogradec, me një mesatare një i rënë në 6 ditë. Shifrat flasin vetë, është pothuajse bilanc luftel?

Në periudhën e pas viteve 1990 veçohen:

- ngjarja e 10 prillit 1994 në postën e Kufirit Peshkëpi, Gjirokastrë, ku me një akt terrorist u vranë në mes të natës, brenda në godinën e postës oficeri Fatmir Shehu dhe ushtari Arsen Gjini, si edhe u plagosën 3 ushtarë të tjerë,

- Vrasja në krye të detyrës e policit Allaman Dervishi më 24 maj 2004 nga një gardist me armën e një punonjësi policie, pra është një vrasje brenda organizatës,

- ngjarja e datës 7 gusht 2009, ku në një operacion policor për kapjen e një të shumëkërkuari nga drejtësia humbën jetën 4 punonjës policie: oficeri Fatos Xhani dhe policët Kastriot Feska, Alket Dizdari dhe Saimir Duçkollari. Për të tri këto raste në kuadër të veprimtarive përkujtimore këtë vit në nderim të tyre u nderuan vepra arti: përmendore në Peshkëpi, bust për Allaman Dervishin dhe memorial për dëshmorët e 7 gushtit.

Të gjithë duhet të jemi të vetëdijshme se ka vetëm një rrugë nëpër të cilën ecën historia e lirisë. Ajo është rruga e gjakut të dëshmorëve, të cilët në momentet e mëdha historike, ishin të gatshëm të falin gjakun për ardhjen e lirisë dhe ndërtimin e konsolidimin e shtetit shqiptar, pas shpalljes së Pavarësisë e gjer në ditët tona.

Kalojnë vite, kalojnë edhe shekuj e kujtimi për dëshmorët mbetet i freskët përherë në mendjet tona, në kujtesën tonë historike. Brezat që vijnë do t’i mbajnë në zemër dëshmorët, për t’i bërë ata flamuj që valëviten rrugëve e shesheve të atdheut tonë.

Liria ndërtohet me jetë të ndërprera në mes, me gjak, me dëshmorë. Kurse, dëshmorët janë nderi dhe krenaria e çdo popullit dhe e popullit tonë martir. E atij popullit që synoi ta fitojë lirinë në shekuj me radhë dhe që donë e din ta ndërtojë jetën e lirë.

Dëshmorët janë ndërgjegjja më sublimë dhe vetëdija e ngritur lart deri në pedestalin e vetëflijimit. Dëshmorët ringjallën çdo përvjetor dhe festojnë bashkë me ne Ditën e Lirisë.

Kujtimet e vetme që mbeten nga dëshmorët janë përmendoret, lapidarët, bustet, memorialët, emrat e rrugëve e shesheve, emrat e shkollave apo institucioneve publike dhe shpesh herë duhet të meditojmë: sikur ata të ishin gjallë dhe të shikonin si ka ecur atdheu për të cilin ata u flijuan dhe mbase do të mund të reflektojmë për ato gjëra që s’janë bërë mirë dhe që amanetin e tyre në saj të politikave jo fort të gjetura qeverisë nuk e kemi çuar atje ku ëndërronin ata.

*\*Përmbledhje e kumtesës së mbajtur në Konferencën e X-të Shkencore të Akademisë së Sigurisë, “Policia e Shtetit në 80-vjetorin e çlirimit të atdheut, arritje dhe sfida”, organizuar në kuadër të “Vittit Mbarëkombëtar të 80 - të vjetorit të Çlirimit”.*

## ANALIZA

Qëndroi në krah të Qemal Stafës dhe do të njihet si figurë e dytë e rinisë shqiptare

# NAKO SPIRU, UDHËHEQES I LANÇ DHE NDËRTUES I SHTETIT DEMOKRATIK



Nga Daut HOXHA

Në historinë tonë të re e moderne, vitet '30 dhe '40 përfaqësojnë një nga etapat e saj më të qënësishme për afishimin e republikanizimit dhe të një shteti demokratik. Me gjithë varfërinë e madhe, njëherazi vendi ynë në këtë kohë përfshihet në vorbullën e Luftës së Dytë Botërore, duke pësuar pushtimin nazifashist.

Pikërisht në këtë hapësirë historike do të spikasin politikanë dhe patriotë e mendimtarë demokratë që fatet e atdheut i shqetësojnë dhe, pse këto fate vireshin në diskutim, do të sakrifikojnë gjithçka në emër të këtij ideali.

Kjo gjeneratë paraqiste gjithë biografinë e Atdheut tonë, si Sejfulla Malëshova, Ndoc Çoba, Ymer Dishnica, Kamber Qafmolla, av. Skënder Muço, Mustafa Gjinishi, publicistja Musine Kokalari, Zef Malaj, Qemal Stafa, Abaz Kupi etj. Në mesin e tyre do të dallohej dhe emri e figura e një politikani të ri, ai i Nako Spirut. Një erudit dhe poliglot, mbi të gjitha një kronist analitik që, me një periudhë kohe të shkurtër krijoi një portret të besueshëm. Këtu do të shënoja një paralele me kryerilindasin tonë, filozofin, shkencëtarin Sami Frashëri.

Nako Spiru lindi në Durrës, në një familje me tradita patriotike qytetare. Mjedisi i qytetit të lindjes dhe njëherazi si portë kryesore e lidhjes me Perëndimin u bë vatra e parë e edukimit dhe formimit të tij patriotik, qytetar e demokrat.

Në përgatitjen e tij profesionale do t'i përshtatej traditës dhe do ishte vazhdues i profilit të tij që dallohej për veprimtari afariste biznesi.

Si mbaroi shkollën fillore në qytetin e lindjes ai ndjek shkollën e mesme tregtare italiane në Korfuz, për t'i vazhduar mbas mbarimit të saj studimet e larta në Torino të Italisë. (Çdo vizitor, sapo të shikojë bibliotekën e familjes Spiru, megjithëse të shkatërruar nga bastisjet nazifashiste, do të ndeshet aty me një gamë titujsh filozofikë, gjuhëtarë, po në veçanti dallohen ato të shkencave ekonomike dhe biznesit. Këto datojnë vitet '36 - '40.) Ai, njohës i gjuhëve moderne europiane si italisht, gjermanisht, frëngjisht, njëherazi dallohej dhe në gjuhët klasike greko-latine. Kjo njohje gjuhësore i dha mundësinë të thithë një shkallë të lartë informacioni, çka e dalonte atë në mes të të rinjve universitarë, duke e vënë atë në rolin e udhëheqësit të tyre.

Këtu, së bashku me Qemal Stafën, do të fillojnë organizimin e rinisë studentore antifashiste, po kështu së bashku shtrinë influencën edhe tek studentët ushtarakë. Ishin kohë të vështira, fashizmi po përgatitej të pushtonte vendin tonë, veprimtaria revolucionare e Qemalit dhe Nakos ranë në sy të organeve sekrete policore si SIM dhe OVRA, të cilët citonin se studenti shqiptar Nako Spiru është ideatori i kundërshtisë së studentëve universitarë në përgjithësi dhe të studentëve ushtarakë për mosbindje në veçanti. Kjo gjë u pa kur në Torino po bëheshin përgatitje për një vizitë zyrtare të Duçes atje.

Në muajt e parë të vitit 1939 shkon disa herë në Paris dhe atje mbështet nismën e Federatës së Studentëve Antifashistë dhe të emigrantëve shqiptarë

Konferenca e Pezës, 16 Shtator 1942, do ta afirmonte Nako Spirun si politikan modern dhe me bindje perëndimore. Ai jo vetëm që kontribuoi në organizimin e saj duke u bërë mbështetësi kryesor i Ymer Dishnicës dhe Mustafa Gjinishit, por do të ishte dhe nismëtar për zgjedhjen në organet drejtuese të saj të personaliteteve me alternativë ndryshe. Ai votoi për përfaqësim balancues dhe të ekuilibruar

• *Nako Spiru me cilësinë e detyrave që kishte mbi supe bëri përpjekje maksimale që Shqipëria të mos rrëshqiste drejt Lindjes dhe aq më pak të bëhej pjesë e Jugosllavisë Titiste. Ky qëndrim dhe devotshmëri e çoi drejt vdekjes nga trysnia e diktatorit dhe veglave të tij Koçi Xoxe e Pandi Kristo, njëri teneqexhi e tjetri marangoz. Ai gjeti rrugën më të ndershme dhe aktin sublim për të thënë:*

*Popull kujdes, diktatura u vendos.*

*Historia dallohet nga paralelet e saj por në diktatura të tipit Enverian ka një ngjyrë, vrasje, terror dhe përçudnim....*

në Francë për veprimtari patriotike dhe antifashiste në mbrojtje të interesave të vendit tonë kundër pushtimit fashist.

Aty së bashku me organizatorët e Federatës si Ali Kelmendi, doktor Ymer Dishnica, Zai Fundo etj, organizojnë mitingje protestash. Nako Spiru shpalo si entuziazmin patriotik dhe me fjalimet e mbajtura ngriti peshën masën e pjesëmarrësve në ato mitingje.

Siç pohon Dr. Ymer Dishnica, (fjalën e tij e konfirmoi motra e tij Eleonora e datëlindjes 1914) ... aty Nako Spiru me përsëritjen e tij bëri zbërthimin e situatës duke përcaktuar detyrat e lëvizjes. Të gjithë panë se kishin të bënin me një politikan të kompletuar dhe analist të shquar historiko-shoqëror.


Me qëllim që të ishte më afër shokëve i kërkon familjes mbështetje që të vazhdojë studimet në Francë; familja e përkrahu, i siguroi mjetet financiare dhe ia dërgoi me ndihmën e Dr. Enver Sazani dhe të gruas së zotit Medar Shtylla.

S'që e thënë, pushtimi fashist i vendit, situata e re politike e kohës e detyruan me ndjenjën e përgjegjësisë qytetare të ndërpriste studimet dhe të kthehej në Shqipëri, aty nga vera e vitit '39. Në qytetin e lindjes agjitoi në masën e bashkëqytetarëve dhe të punëtorëve si të STAMLES, Portit Detar, Ndërmarrjes Kruga-Ura dhe në veçanti të shkollës qytetëse. Organizon demonstratat e para '39 - '40. Ky aktivitet ra në sy dhe për të larguar vëmendjen e organeve fashiste nis përsëri në Itali studimet.

Lufta Italo-Greke dhe ndryshimet e reja të situatës politike e bëjnë që të kthehet përsëri në Janarin e vitit '41. Meqë familja ishte shpërngulur në Kavajë, në këtë kohë ai ishte i survejuar dhe për organet e pushtimit përbënte rrezikshmëri, arrestohet me motivin e shpërndarjes së trakteve antifashiste në qytetet Kavajë, Durrës, Tiranë. Nako Spirun e burgosën dhe e mbajtën në burgun e xhandarmërisë së Durrësit. Me ndërhyrje dhe për mungesë provash ai lirohet me kusht që të shkonte në Torino për të vazhduar studimet, gjë që lehtësonte survejimin e tij atje. E shfrytëzoi rastin, u largua përkohësisht për t'u kthyer përsëri në verën e vitit '41, kohë që hidhet plotësisht në ilegalitet.

Mungesa e tij në Itali në universitetin e Torinos, po kështu mungesa e tij në veprimtari legale vuri në lëvizje operative policinë sekrete fashiste dhe për këtë qëllim, me porosi të kryeministrit Mustafa Kruja, i bëjnë presion familjes, thirret në kryeministri i ati, Perikli Spiru dhe i japin ultimatum: "O djalin në Itali në universitet, ose ta dorëzoni atë, ndryshe do t'ju burgosim dhe internojmë familjarisht, ose do t'ju djegim pasuri e shtëpi".

Perikli Spiru dhe gjithë familja protestuan dhe pas kësaj proteste ata u internuan në Burrel dhe në Krujë. Edhe këtu presionet nuk munguan, kërkimin dorëzimin e Nako Spirut me ngulm, tashmë e gjithë familja ndjente përgjegjësi dhe e mbështeti



veprimtarinë antifashiste patriotike të djalit të saj, që momentalisht ndodhej në Tiranë, tek shtëpia e patriotit Kleanthi Papa (daja i tij në rrugën e Postës së Vjetër, Nr.3).

Në këtë bazë fillon perioda e dytë e veprimtarisë patriotike revolucionare antifashiste për çlirimin e vendit. Ai merr kontakte me personalitete të vjetër dhe të rinj që ishin vënë në shërbim të Luftës Antifashiste si Spiro Bakalli, doktor Enver Sazani, Silo Bogda, Shefqet Beja, kolonel Kamber Qafmolla, politikanin dhe burrin e shtetit Ndoc Çoba dhe Mustafa Gjinishi, doktor Ymer Dishnica.

Kjo veprimtari dhe ky kontribut falë kapacitetit të tij e vendosën atë dhe e bënë të njohur si figurë drejtuese të luftës në shkallë kombëtare.

Eshtë koha kur me lëvizjet e tij në mbarë vendin për të agjituar Luftën Antifashiste në masat popullore, në veçanti tek figurat me besim në popull, ai do të njihet me avokat Skënder Muçon, dhe profesorët e Tregtarës së Vlorës si prof. Jusuf Luzaj apo me prof. Abaz Ermenjin, gjithashtu ai merr kontakt e bisedon me oficerin e karrierës Hysni Lepenica e të tjerë. Aty ai gjeti gjuhën e përbashkët për të mbështetur Dr. Ymer Dishnicën e Mustafa Gjinishin për organizimin e një mbledhjeje apo konference vendore për të krijuar një organ qendror të drejtimit të Luftës Antifashiste.

Lëvizja komuniste arriti, si rezultat i nevojës imperative të kohës, të krijojë Partinë Komuniste Shqiptare. Meritë për këtë kanë personalitetet e lëvizjes si Koço Tashko, Qemal Stafa, Nako Spiru, Tuk Jakova, Sadik Premtja, Ramadan Çitaku, Mustafa Gjinishi, Ymer Dishnica etj.

Ai do të qëndrojë në krah të Qemal Stafës dhe do të njihet si figurë e dytë e rinisë shqiptare. Pas vrasjes tradhëtisht të Qemal Stafës, Nako Spiru (Deti, pseudonimi i luftës) do të zgjidhet Sekretar Politik i Rinisë dhe po kështu, në muajt e parë të vitit '42 u kooptua në Komitetin Qendror të PKSH. Falë formimit të tij në gjithë planet dhe si politikan i alternativave të ndryshme, ai bëri të mundur të tërheqë në radhët e Lëvizjes qindra e mijëra të rinj e të reja, pavarësisht nga pikëpamjet kulturore dhe politike ndryshe. Në metodat e punës së tij përgatitja e lartë intelektuale bëri që shumë drejtues të rinisë

## PROFILI



# Alfred Moisiu, jeta dhe karriera e pasur e një ushtaraku dinitoz e të talentuar

(Vijon nga faqja 3)

ndryshime të cilat u miratuan. Konkretisht aparati që ishte direkt në vartësi të ministrit të ndahej në bllokun politik me zëvendësministër A. Moisiu dhe blloku ekonomik ... Kështu në këtë kohë u krijua Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë si dhe Dega e Veteranëve të Luftës. Vlerësoi krijimin e shoqatës shqiptare të Atlantikut dhe punoi për vazhdimësinë e aktiviteteve të saj dhe pas largimit nga Ministria e Mbrojtjes. Përherë lajtmotivi i Alfred Moisiut ishte

që nëpunësi i shtetit dhe shtetari duhte të punojnë me ndershmëri, duke mos abuzuar kurrsesi me detyrën e ngarkuar. Motoja e punës në raport me detyrat shtetërore gjithmonë ka qenë: të bëj detyrën dhe shteti të mendojë për mua (ushtarakun). Me gjithë angazhimet e mëdha në drejtimin e ushtrisë, në punën administrative, drejtuese dhe në veprimtarinë mësimore e shkencore, Dr. Alfred Moisiu ka një prodhimtari të pasur botuese. Ai është autor dhe bashkëautor i disa teksteve mësimore për xhënon shqiptare, por dhe i disa librave, si dhe i një

numri të madh me artikuj, referime shkencore dhe studime të botuara në organe të ndryshme të vendit e të huaja. Dr. Alfred Moisiu dhe në moshën 95 vjeçare, përsëri është një emër i ndritur në historinë e arsimit të lartë ushtarak dhe të shkencës ushtarake shqiptare.

*\*Mbajtur në Sesionin Jubilar për jetën dhe veprën e dr. Alfred Moisiu, organizuar nga Instituti i Studimit të Historisë Ushtarake në Akademinë e Shkencave më 14.12.2024.*

## NAKO SPIRU, UDHËHEQES I LANÇ DHE NDËRTUES I SHTETIT DEMOKRATIK

(Vijon nga faqja 6)

dhe të luftës ta donin dhe ta nderonin, pse jo dhe ta kishin idhullin e tyre.

### QËNDRIMI NË KONFERENCËN E PEZËS

Ai lëvizte shumë në mbarë vendin, por gjithnjë ishte udhëheqës dhe drejtues në Tiranë, ngaqë e kuptonte drejt rolin e qytetit në luftën për çlirimin e vendit. Për vlerat dhe rolin e qytetit në këtë drejtim, në veçanti të qytetarit, do të gjenden shkrime dhe dokumenta të kohës me firmën "Deti", si në organet e kohës së luftës, "Zëri i Popullit", "Bashkimi", Kushtrimi i Lirisë" dhe në të gjitha dokumentat, traktet, qarkoret dhe në veçanti në rezolucionet e aktivave të ndryshëm.

Konferenca e Pezës, 16 Shtator 1942, do ta afirmonte Nako Spirun si politikan modern dhe me bindje perëndimore. Ai jo vetëm që kontribuoi në organizimin e saj duke u bërë mbështetësi kryesor i Ymer Dishnicës dhe Mustafa Gjinishit, por do të ishte dhe nismëtar për zgjedhjen në organet drejtuese të saj të personaliteteve me alternativë ndryshe. Ai votoi për përfaqësim balancues dhe të ekuilibruar. Për Kryetar të Kuvendit të Konferencës u zgjodh politikani patriot, burrë shteti dhe i çështjes kombëtare Ndoc Çoba. Kryetar i Këshillit Drejtues u zgjodh koloneli Kamber Qafmolla dhe sekretar i Këshillit publicisti dhe organizatori Mustafa Gjinishi. Gjatë punimeve të Konferencës dhe më vonë ai punoi me avokat Skënder Muçon dhe shkrimtaren dhe publicisten Musine Kokalari për krijimin e një Alternative të Qendës së Majtë. Ide që mori zhvillim në ngjitje fill pas kapitullimit të Italisë Fashiste (8 Shtator 1943). Me pushtimin nazist të vendit ai së bashku me shumë personalitete të tjerë të Luftës ishin të ftuar aty për këtë ngjarje historike madhore për kohën. Siç shkruan publicistja Musine Kokalari në ditarin e saj "...U

mblodhëm në një shtëpi në rrugën e Elbasanit, rreth 60 vetë ... Aty avokat Skënder Muço parashitri pas shumë debatesh dhe pikëpamjesh Partinë Social Demokratike të Shqipërisë. Kjo ka ngjarë në javën e parë të muajit Tetor të vitit 1943...". Për njohjen dhe afishimin e kësaj Alternative të re Social Demokratike u botua organi "Zëri i Lirisë" (u botuan vetëm 6 numra).

Kjo Alternativë e afishoi veten në luftën për çlirim, por në veçanti në vitet e para të pas çlirimit siç është aksioni politik zgjedhor, ai për zgjedhjen e Asamblesë Kushtetuese, 2 Dhjetor 1945. Në këtë plan u realizuan një sërë veprimtarish me grupet e ndryshme politike nacionaliste që vepronin mjerisht në gjysëm ilegalitet ngaqë në këtë kohë gradualisht po instalohej sistemi diktatorial. Avokat Skënder Muço u vra tradhëtisht bashkë me shokë të tjerë të kësaj alternative më 15 Gusht 1944 nga bashkëpunëtorët nazistë si prefekti i Vlorës Vizhdan Risilia, ndërta publicistja Musine Kokalari vdiq e harruar dhe e persekutuar pas burgimit disa vjeçar në internim në qytetin e Rrëshenit, kurse prof. Gjergj Kokoshi u pushkatua nga diktatura dhe diktatori, ngaqë me aktin e tij qytetar "dorëheqje nga posti i Ministrit të Arësimit" i tha popullit dhe politikës shqiptare që diktatura tashmë është vendosur. Kjo situatë zgjedhore për Asamblenë çoi në satër dhjetra intelektualë, politikanë bile dhe të zgjedhur siç ishin në Konferencën e Pezës Mustafa Gjinishi, Dr. Ymer Dishnica, Sejfulla Malëshova, të cilët i varrosi nën trysninë dhe presionin politik deri në vdekjen e tyre.

### MOMENTE TË RËNDËSISHME TË LANÇ KU SPIKAT AFTËSIA DHE QARTËSIA PREJ UDHËHEQËS

Dy nga momentet e rëndësishme të Luftës Antifashiste ku spikat aftësia dhe qartësia prej udhëheqësi si dhe kuptimi demokratik i situatës janë 1- Operacioni i Dimrit i vitit 1943 - 1944 dhe 2- Veprimtaria e Delegacionit të

Frontit Antifashist në Konferencën e Mukjes, Gusht 1943.

Në valën e këtij operacioni Nako Spiru (Deti) qëndroi gjithë kohën në Tiranë, ruajti dhe mobilizoi organizatën dhe mbi këtë bazë besimin e popullit për fitore. Gjatë këtij operacioni të egër nazist mbijetoi organizata e Tiranës dhe e Korçës. Në këtë situatë ai jo vetëm që ruajti strukturat e organizatës por, me ndihmën e qytetarëve patriotë të Tiranës, bëri të mundur të kurojë dhe riaftësojë partizanë të Brigadës II dhe III që u goditën rëndë nga nazizmi. Ata u mjekuan dhe u bënë efektivë për luftë.

Në arkivat qëndrore dhe lokale do të gjenden dhjetra letra me porosi dhe udhëzime të kohës që duhen klasifikuar dhe të bëhen pjesë e dëshmisë së Luftës Antifashiste. Akademia e Shkencave e Shqipërisë duhet ta ketë parasysh këtë në përgatitjen e librit të Historisë së Shqipërisë.

Humanizmi dhe bindjet e tij prej demokrati dhe "jo idealisti" rrjedhin nga baza dhe origjina e tij shoqërore dhe shkalla e formimit të tij me bindje perëndimore. Ai, falë vlerave enciklopedike, diti të vlerësojë dhe të bëjë të tijën, së bashku me mendimtarë të tjerë, siç kam thënë më sipër, si dhe të përqafojë e të inicojë alternativat e kohës siç është ajo Social Demokratike. Ai ishte një politikan human dhe i mendimit ndryshe dhe mbështetëj në përcaktimin e aleancave koniunkturale duke pasur parasysh që ato t'i shërbenin strategjisë. Kjo gjë u pa me largpamësinë në mbrojtjen dhe pranimin e veprimtarisë së delegacionit të Frontit në mbledhjen e Mukjes. Ai qëndroi përkrah dy njerëzve të mëdhenj, Dr. Ymer Dishnicës dhe Mustafa Gjinishit.

Interpretimi voluntarist nga Enver Hoxha i kësaj veprimtarie që donte t'i dënonte me ashpërsi këta dy persona gjeti kundërshti absolute nga Nako Spiru dhe i tregoi diktatorit se ky qëndrim përfaqëson rrezikshmëri për zhvillimin e mëtejshëm të Luftës Antifashiste.

Me çlirimin e vendit s'që e thënë që këta njerëz, mendimtarë demokratë t'i gëzohen punës titanike të tyre. Zhvendosja drejt Lindjes do të shikohet si finish kohe me zgjedhjet e 2 Dhjetorit '45 për Asamblenë Kushtetuese ku grupi i demokratëve reformatore me Prof. Sejfulla Malëshovën kërkoi një fushatë zgjedhore demokratike dhe pluraliste. Kjo kërkesë ra ndesh me grupin e "mballomaxhinjve" dhe fill pas tyre ata do të shkonin drejt asgjësimit.

### KOHA KUR GRUPET E NDRYSHME POLITIKE FORMOJNË "FORUMIN DEMOKRAT"

Eshtë koha kur grupet e ndryshme politike formojnë "Forum Demokrat" dhe nën përkujdesjen direkte të Sejfulla Malëshovës përgatitjen "Promemorian" për një fushatë demokratike drejtuar Misioneve Aleate me detyrë shtyrjen e kohës së zgjedhjeve dhe rishikimin e ligjit zgjedhor. Këto dy gjëra nuk u pranuan nga qeveria shqiptare.

Në hartimin e kësaj promemorieje u angazhuan social-demokratët Musine Kokalari dhe Gjergj Kokoshi. Nako Spiru në këto vite të para zhvillon një punë organizative e ligjore për ngritjen e shtetit demokratik. Këtu ai gjen mbështetje nga legjislatorë dhe ekonomistë të kalibrit perëndimor si Riza Dani, Shefqet Beja, Manol Konomi dhe të tjerë.

Nako Spiru me cilësinë e detyrave që kishte mbi supë bëri përpjekje maksimale që Shqipëria të mos rrëshqiste drejt Lindjes dhe aq më pak të bëhej pjesë e Jugosllavisë Titiste.

Ky qëndrim dhe devotshmëri e çoi drejt vdekjes nga trysnia e diktatorit dhe veglave të tij Koçi Xoxe e Pandi Kristo, njëri teneqexhi e tjetri marangoz. Ai gjeti rrugën më të ndershme dhe aktin sublim për të thënë:

Popull kujdes, diktatura u vendos. Historia dallohet nga paralelet e saj por në diktatura të tipit Enverian ka një ngjyrë, vrasje, terror dhe përcudnim.

## NDERIMI

**Këshilli Bashkiak përjetëson emrin e dëshmorit të atdheut, rënë në betejën legjendare të Kolesjanit**

# RRUGA “EMIN CIBAKU”

- Rivlerësimi i Heronjve dhe Atdhetarëve në këndvështrimin europian të një shoqërie demokratike i lartëson dhe përjetëson aktet e tyre në realitetet e reja aktuale dhe të perspektivës së kombit. Ai është një refleks i përmbajtjes dinamike të vetë historisë së një kombi

**Halil RAMA – Mjeshtër i Madh**

Vlerësimi i heronjve dhe dëshmorëve të atdheut, përveçse akt juridik dhe politik, është detyrimi ynë moral, si dhe i çdo gjeneratë shqiptare, ndaj historisë dhe së ardhmes të kombit tonë.

Nderimi për luftëtarët që sakrifikuuan dhe flijuan jetën për lirinë e Shqipërisë është shprehja më e drejtpërdrejtë e atdhedashurisë që duhet të mbartë çdo shqiptar, pavarësisht bindjeve politike.

Parë nga ky këndvështrim, përjetësimi i emrit të dëshmorit të atdheut Emin Cibaku (me një vendim unanim të Këshillit të Bashkisë Dibrë) duke i vendosur emrin e tij segmentit rrugor nga kryqëzimi i rrugës Peshkopi - Kukës deri në qendër të fshatit Sohodoll, është ndër vendimet më të vlerësuara nga komuniteti dibran e më gjerë. Kjo për faktin se vlerësimi i gjakut të derdhur për Shqipërinë është borxhi, që kemi të gjithë ne që gëzojmë lirinë ndaj sakrificës së tyre sublime.

## PAK NGA HISTORIA...

Dëshmori i atdheut Emin Habedin Cibaku ka lindur në Sohodoll të Dibrës rreth vitit 1856. Ishte i martuar me Sibe Veselin nga Cetushi, dhe kishin tre fëmijë: Habedin, Qamili dhe Shiretja (Vraniçi). Jetonin së bashku me vëllain e tij më të madh, Abdullahin. Familja e tyre janë marrë me bujqësi e blegtori.

Në vitet kur Perandoria Osmane po jetonte fundin e saj, vendet fqinje shtuan përpjekjet për aneksimin e trojeve shqiptare: serbët e malazezet në Veri dhe grekët në Jug. Duke konkretizuar orekset e tyre shoviniste, deri në fillim të nëntorit 1912, serbët kishin pushtuar Prizrenin, Gjakovën e Hasin, dhe po përgatiteshin me forca të shumta për të sulmuar Lumën e Dibrën, dhe pastaj t'i drejtoheshin Durrësit.

Ndërkohë, në anën tjetër, forcat atdhetare po mobilizonin vullnetare në Dibër e Lumë, për të mbrojtur tro-



- Albanologu i mirënjohur ROBERT ELSIE, në artikullin “Masakrat serbe në Dibër, 1913”, botuar në gazetën e përditshme Corriere delle Puglie, Bari, XXVI, 354, e 21 dhjetorit 1913. [nga anglishtja Gëzim Aliu] [botuar edhe në: Albanica Ekskluzive: revistë mujore për dije e kulturë, Prishtinë, 73-74, tetor/nëntor 2007, f. 17- , ndër të tjera shkruan se: “..... Në Sohodoll, i dogjën tri shtëpi dhe i masakruan katër burra: Abdullah Abedinin, Tusun Dalipin, Sulejman Bahtiarin dhe Dalip Ismajlin, si dhe një grua me emrin Belure dhe të birin e saj gjashtëvjeçar me emrin Mazllum. Po ashtu, i vodhën edhe 200 dele e 30 kuaj....”

jet amtare. Edhe nga Sohodolli dolën dhjetra vullnetarë që rrokën armët për t'i dalë zot atdheut.

“Të shkoni e të vini shëndoshe”- i uruan bashkëfshatarët që kishin dalë për të përcjellë luftëtarët. “Nëqoftëse e çojme serbin në Beograd, kthehem në Sohodoll, në të kundërt jo, se nuk e duroj serbin ndër gra e fëmijë.”- iu përgjigj Emin Cibaku.

Sipas historianëve, rreth 3 mijë luftëtarë lumjanë dhe 1 mijë dibranë, ishin vendosur në mbrojtje në Qafën e Kolesjanit përballë mbi 20 mijë ushtarëve serb. “Ishim vendosur në vijën e parë të mbrojtjes me Eminin, Brahim Përgjegjin e Beqir Bushin”-tregonte Dalip Tafa pas kthimit në Sohodoll.

“Lufta filloi e ashpër, plumba e predha, të vrarë e të plagosur nga të dy anët. Erdhi urdhëri për një tërheqje, për të zënë pozicione të reja luftime. Tërhiquni ju, - thotë Eminin, unë po vazhdoj të hap zjarr që t’ju mbroj gjatë tërheqjes. Por, sapo ishim larguar pak, Eminin goditet në gjoks nga një plumb armik. Kthehem menjëherë, dhe me disa bashkëluftëtarë, marrim trupin e pajetë të tij, dhe ia dërgojmë imamit të fshatit për ta varrosur, sepse ne u kthyem menjëherë në frontin e luftës” - ka treguar Dalipi për rënien e Eminin në luftën e Kolesjanit.

Siç shkruan akademik Fatos Daci – Mjeshtër i Madh: “Forcat shqiptare, dibrane e lumjane korren një fitore të shkëlqyer, duke asgjësuar plotësisht ushtrinë serbe, e cila la në fushën e betejës plot 12.000 të vrarë. Kjo betejë, unikalë për nga përmasat, heroizmi dhe të vrarët që një Termopile shqiptare dhe një Vaterlo për serbët”.

## HAKMARRJA SERBE NJË VIT PAS HUMBJES SË MADHE NË BETEJËN E KOLESJANIT


Një vit më vonë, në tetor 1913, barbarët serb kryen masakra të tmerrshme mbi popullsinë civile në Dibër, duke djegur e plaçkitur, duke vrarë e prerë gra, fëmijë e pleq. Në Sohodoll vranë edhe vëllain e Eminin, Abdulla Cibaku, si dhe plaçkitën bagëtitë dhe dogjën shtëpitë e tyre.

Për këtë, mjafton ti referohemi albanologut të mirënjohur ROBERT ELSIE, i cili në artikullin “Masakrat serbe në Dibër, 1913”, botuar në gazetën e përditshme Corriere delle Puglie, Bari, XXVI, 354, e 21 dhjetorit 1913. (nga anglishtja Gëzim Aliu) (botuar edhe në: Albanica Ekskluzive: revistë mujore për dije e kulturë, Prishtinë, 73-74, tetor/nëntor 2007, f. 17- ) , ndër të tjera shkruan se: “.....Në Sohodoll, i dogjën tri shtëpi dhe i masakruan katër burra: Abdullah Abedinin, Tusun Dalipin, Sulejman Bahtiarin dhe Dalip Ismajlin, si dhe një grua me emrin Belure dhe të birin e saj gjashtëvjeçar me emrin Mazllum (Methasani). Po ashtu, i vodhën edhe 200 dele e 30 kuaj....”

Për kontributin e tij ndaj atdheut, Emin Cibaku është vlerësuar nga Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor të rrethit Dibër, i cili me vendimin nr. 72 datë 23.5.1978 e shpall: “DËSHMORI I ATDHEUT”.

Këshilli i Komunës Kastriot, me vendimin nr. 28 datë 15.11.2012 e shpall: “NDERI I KOMUNES”.

Këshilli Bashkiak Dibër, me vendimin nr. 11, datë 31.01.2024 vendosi që, segmenti rrugor nga kryqëzimi i rrugës Peshkopi - Kukës deri në qendër të fshatit Sohodoll, të emërtohet: Rruga “EMIN CIBAKU”, duke përjetësuar kështu emrin e tij.



## NDERIM DHE VLERËSIM NDAJ VETË IDENTITETIT TONË KOMBËTAR


Vlerësime të tilla si ai i Këshillit të Bashkisë Dibër për dëshmorin e atdheut Emin Cibaku është në radhë të parë nderimi dhe respekti ndaj vetë identitetit kombëtar, ndaj integritetit si shqiptarë dhe dinjitetit tonë njerëzor.

Rivlerësimi i Heronjve dhe Atdhetarëve në këndvështrimin europian të një shoqërie demokratike i lartëson dhe përjetëson aktet e tyre në realitetet e reja aktuale dhe të perspektivës së kombit. Ai është një refleks i përmbajtjes dinamike të vetë historisë së një kombi.

Vlerësimi dhe rivlerësimi i kontributit dhe akteve historike të Heronjve, Dëshmorëve apo Atdhetarëve të shquar, përherë është lidhur dhe duhet të lidhet me interesin mbarëkombëtar dhe jashtë këndvështrimit politik aktual apo të kohës në të cilën janë kryer këto akte.

Në këtë kontekst duhet vlerësuar edhe Beteja e Kolesjanit e nëntorit 1912 (e njohur si prelude i pavarësisë), kur rreth 4000 lumjanë e dibranë, të armatosur ishin pozicionuar në formë patkoi, duke harkuar mbi pozicionet serbe, poshtë Qafës së Kolesjanit, nga lindja e perëndimit.

Beteja e Kolesjanit, gjatë së cilës ra dëshmor edhe trimi Emin Cibaku nga Sohodolli, meriton vëmendjen e duhur nga historiografia jonë kombëtare, pasi ajo pengoi drejtpërdrejt forcat e Armatës së Tretë serbe, duke i gjakosur, rraskapitur e vonuar në realizimin e qëllimit serb, për të dalë në Adriatik e për të bërë fakt të kryer pushtimin e Shqipërisë para Shpalljes së Pavarësisë sonë Kombëtare.





## IN MEMORIAM

Në 556 vjetorin e vdekjes së Heroit tonë Kombëtar Gjergj Kastriot Skënderbeu

# Ismail KADARE: Portreti i Skënderbeut



**N**ë 556 vjetorin e vdekjes së Heroit tonë Kombëtar, Gjergj Kastriot Skënderbeu, redaksia e gazetës "Veterani" zgjodhi të botojë poezinë e shkrimtarit onë të madhe, Ismail Kadare: "Portreti i Skënderbeut". Për 25 vjet Skënderbeu mbajti të papushtuar Arbërinë nga ushtria osmane që e sulmoi atë dhjetra herë duke u bërë mbrojtës jo vetëm i kësaj toke por edhe i krishtërim-it në Evropë. Për shkak se Skënderbeu u bë diga, mbrojtja dhe rezisteca e krishterë ndaj ushtrisë osmane, Evropa dhe Vatikani e kanë cilësuar heroin kombëtar të shqiptarëve, si atlet i krishtit dhe pararendës të aleancës Atlantike NATO. Më mirë se kushdo tjetër, Skënderbeun - "Hero i Kombit Shqiptar", titulli më i lartë dhe i vetëm që mban një shqiptar e portetizon në vargjet e mëposhtme Ismail Kadare, shkrimtari më i mirë i letërsisë shqipe, ndër shkrimtarët më të mirë të letërsisë botërore bashkëkohore, dhe autori më i përkthyer jashtë vendit, fitues i disa çmimeve letrare ndërkombëtare dhe i nominuar me dhjetëra herë për çmimin Nobel....

## Fol moj shpatë e Skënderbeut

### Fragment poeme nga Mevlud BUCI

Sa shekuj pas do të vijnë,  
E dielli do të ngrohë dhenë;  
Lindin ato krenarinë  
E kujtojnë Skëndetbenë.

Skënderbe o Skënderbe,  
Ti hyjnor e legjendar;  
Për këtë popull e për këtë dhe  
Mbetë dritë në altar...

Mbetë dritë në altar,  
Diell i zjarrtë i lirisë,  
Shpirt e krah i ke thesar,  
Prijs i rrallë i Arbërisë...

Prijs i rrallë i Arbërisë,  
Bash vigan të njeh ty bota,  
Na dhae dritën e pavdekësisë  
Legjendar rrit nëpër shqota..

### PORTRETI I SKENDERBEU

Si ditë e plotë ai shtjellej  
Me re dhe erë përmbi atdhe.  
Një emër Gjergj e kish si diellin  
Tjetrin si hënën, Skënderbe.

Dy brirë dhie kish mbi krye  
Emblemë e vjetër e çuditëshme  
Sikur ta dinte që mes brirëve  
Dy perandorë do të godiste.

Njëzet e katër luftëra bëri  
Njëzet e katër vdekje theu  
Çka mangut linte ditën Gjergji  
Plotësonte natën Skënderbeu.

Pas vdekjes eshtrat iu ndanë  
Në mijëra varre ata u shtrinë  
Gjithçka të shumtë ai e pati  
Të vetme kish veç Shqipërinë.



### TE KULLA E GJONIT

#### HALIL RAMA

"Te kulla e Gjonit!", një arkeolog,  
Në vite, gërmoi shumë gjatë;  
Hodhi plot gjurmë në katalog  
Nga ky toponim i lashtë....

Një ditë si i marrë sa s'futuroi:  
Tha, këtu është vendlindja e Gjergjit,  
Atë që kërkonte më në fund zbuloi,  
Përkrenaren, gjeti në rrënojat e Gardhit.

"Ta dini se gjyshi i Zotit Skënderbe,  
Veç këto dy fshatra kish në zotërim";  
Nga këtu shtegtoi në shekuj kjo legjendë,  
Nga vendlindja ime, Gardh e Sinjë.....

### VENDLINDJAIME...

Mal në "Nandë Malet" e Dibrës,  
Jo vetëm për lartësi,  
Muhurri ynë, perlë e natyrës  
Me shumë bëma në histori.

Skënderbeu këtu i ka trojet,  
Në Gardh, Sinë e Mazreka,  
Këtu lindën dhe gjeneralët,  
Nikoll e Dhimitër Berisha.

Këtu i kam legjendat dhe këngët  
Për besëlidhjen e trimave muhurrakë,  
Kur hasmit ia rrëmbyen pushkët  
Vatanit me i dalë hak..

Kur n'beteja Dan Leka u printe,  
Me e shporrë shkjaun nga votra  
Kur n'kuvende Nuz Lala i mblidhte,  
Të keqes me i dalë përpara...

Këtu lindi Dine Hoxha,  
Më i miri i të mirëve të Dibrës,  
Që ligjëroi n'kuvende e oda,  
Gjithnjë projeksion i së mirës.

Këtu ka trojet Gjon Kastrioti,  
Këtu ka hedh rrënjë liria.  
Muhurri im bukuri nga Zoti,  
Mbi të ulur historia.

Legjendat ty të nje bota,  
Dragua lindut vetëtimës,  
Shpëtimtar të pati Europa,  
Kastriot prej Gardhit e Sinës.

Kastriot prej Gardhit e Sinës.  
S'të mposhti garda e Anadollit,  
Skënderbe, bir i Jutbinës  
Fol moj fushë e Torviollit.

Fol moj fushë e Torviollit.  
Fol dhe ti Luginë e Vajkalit,  
Ndaj pushtuesve prej Anadollit  
Skëndebeu n'majë të kalit...

Mposhte errësirën, dridhe shkrep  
Lule e Arbërisë, kohës e dheut  
Dalin flakë me afshe të nxeht  
Fol moj shpata Skënderbut...

## PORTRET

*Rrallë ndodh që një pedagog të ishte kaq i kulturuar, i urtë dhe fisnik njëkohësisht*

# NJË SHEKULL JETË E PROFESOR NEXHMEDIN MISIRIT

• *Në vitin 1971 fitoi titullin “Docent” dhe 1995 titullin “Profesor”. Prof. dr. Nexhmedin Misiri është vlerësuar nga Qendra Ndërkombëtare e Biografive Kembrixhit në Angli, si njeriu i shquar i vitit 2000*

**Dr.Hasan DOMI**


**M**e 5 nëntor 2024 prof. dr. Nexhmedin Misiri mbushi plot nëntëdhjetë e nëntë vjeç dhe ashtu i qetë si gjithmonë është nisur tek të njëqintat dhe urojmë që Zoti t'i dhurojë akoma jetë të gjatë, të shëndetshme dhe të lumtur, këtij korifeu të dijes e të shkencës, këtij burri kaq të urtë e të thjeshtë, këtij edukatori të tërë brezash, këtij kontributori të përsëritshëm në fushën e farmakologjisë dhe toksikologjisë veterinarë dhe humane në Shqipëri, këtij burri të madh të kombit tone.

Në fushën e mjekësisë veterinarë kombi ynë ka nxjerrë figura të spikatura me kontribute si në Shqipëri dhe jashtë saj, mund të përmendim këtu Mehmet Akifin, Sejfi Vllamasin, Bilal Golemin, Vasfi Samimin(Visoka), Dhimitër Vavakon, Medar Shtyllën etj.

Profesor Nexhmedin Misiri ishte njëri prej tyre që për fatin e mire jeton akoma e që të gjithë ato të cilët kanë patur fatin ta njohin e ta dëgjojnë janë në një mendje, se rrallë mund të kombinohen tek një person kaq vyrtyte bashkë.

Po kush është profesor Nexhmedini, ku studjoi dhe çfarë veprimtarie jetësore pati në këto nëntëdhjetë e nëntë vjet ?

Shqipëria e varfër e gjysmës së dytë të shekullit XIX e pikërisht në vitin 1876 pati barnatoren e parë hapur në Elbasan nga Sulejman Misiri, gjyshi i profesor Nexhmedinit. Një e dytë barnatore, po këtë periudhe ishte hapur



në Shkodër nga Mozalët (e pikërisht nga kjo familje do të vinte vite më vonë një figure tjetër e madhe në fushën e veterinarisë prof. Moisi Mozali).

Kështu gjyshi Sulejman dhe më vonë i ati Hasani do të ishin farmacistët më të shquar të vendit dhe pikërisht në këto amiente, Dini (kështu e thirrin në Elbasan) do të rritej me barnat, me shqetësimet e problemet e farmacisë dhe me kuriozitetin e fëmijës për efektin çudibërës të shumë barnave. Këtu u njoh me ilaçet, me përgatitjen e shumë e shumë tretësirave dhe melhemeve, ai u bë një farmacist i vogël që ndiente kënaqësinë e punës, e cila do ta shoqëronte gjithë jetën. I ati shikonte zgjuarsinë e të birit, vëmendshmërinë e tij dhe shpresonte në të ardhmen e tij. Nuk gaboi Hasani, pasi Dini i tij do të ishte një trashëgim-

tar i denjë i barnatores së Misirëve dhe njëkohësisht i vetmi pedagog që qendroi në identitetin e tij, që vazhdoi të merret me studime në këtë fushë dhe aktivitet farmaceutik. Pak kush e din, që “MILIFAR” distributor, me aktivitetin më të madh të preparateve veterinarë me president dr. Albert Metani, është emërtim i ideuar nga profesori Nexhmedin Misiri.

Mësimet e para i mori në shkollën ushtrimore të normales, ku mësues pati një intelektual të arsimuar në Austri e që quhej Karl Ljarja, një Shkodran, i cili kontribuoi në arsimimin në normalen e Elbasanit, më vonë në Ministrinë e Arsimit e më vonë pedagog.

Mësimet i vazhdoi në Liceun e Shtetit në Tiranë dhe me fillimin e luftës italo-greke kthehet në Elbasan dhe

përfundon Shkollën Normale.

Në vitin 1947 shkon për studime në San Petersburg (ish Leningradi) në Fakultetin e Mjekësisë Veterinarë deri në vitin 1952 duke përfunduar me diplomën “Shkëlqyeshëm” dhe menjëherë pas përfundimit të studimeve kthehet në Shqipëri, emërohet në “ Shkollën e Mesme Bujqësore” Kamëz - Tiranë. Pas dy vitesh transferohet pedagog i lëndës së Farmakologjisë në Fakultetin e Mjekësisë Veterinarë në Institutin e Lartë Bujqësor.

Nga viti 1963 deri në vitin 1968, profesor Nexhmedin Misiri ishte pedagog edhe i Fakultetit të mjekësisë për lëndën e Farmakologjisë.

Si pedagog, profesor Nexhmedini zhvillonte leksione të një niveli shumë të lartë, zotëronte më së miri auditorin, i bënte leksionet shumë interesante sidomos kur argumentonte e interpretoonte në mënyrë thellësisht shkencore farmakokinetikën, farmakoterapeutikën, farmakodinamikën e barnave, korelacionin dhe ndikimin reciprok ilaç-organizëm, veprimin aktiv në metabolizmin qelizor, dhe gjithë sistemet e organizmit, në klinikën deri në shërimin e organizmit. Ishte kënaqësi të dëgjoje leksionet e tij, mënyra si lidhte lëndën e farmakologjisë me disiplinat e tjera si biokimia, fiziologjia normale dhe patologjike, diagnostikën dhe terapinë. Kush ka mbaruar një fakultet mjekësie, e din më së miri se Farmakologjia është lëndë e vështirë, por është pedagogu ai se si e shpjegon, si argumenton dhe sa të kuptueshme e bën atë. Leksionet ishin të përkryera, komunikimi me studentët ishte shembullor. Rrallë ndodh që një pedagog të ishte kaq i kulturuar, i urtë dhe fisnik njëkohësisht. Nuk kishte si të ndodhte ndryshe kur profesor Nexhmedini punonte gjithmonë për të qenë një pedagog i kompletuar në të gjitha drejtimet. Ai merrte informacionet më të reja si nga vendet e Lindjes dhe të Përendimit, falë njohurive në gjuhët e huaja anglisht, rusisht, frëngjisht, italisht.

Në vitin 1972 kreu një specializim gjashtë mujor në Institutin e Farmakologjisë dhe Terapisë Eksperimentale të Fakultetit e Mjekësisë Veterinarë të Universitetit Milanos. Kështu profesor Nexhmedini do të ishte një toksikolog me njohuri të thella. Si i tillë do të punonte shef i sektorit të toksikologjisë në Institutin e Kerkimeve Veterinarë nga viti 1974 deri në vitin 1983, vit kur doli në pension. Por leksionet në fakultetin e Mjekësisë Veterinarë do të ishin pjesë e punës dhe kënaqësisë së tij. Si udhëheqës shkencor ka udhëhequr 10 doktorantë në farmakolog-

(Vijon në faqen 11)

**REKUIEM**

*Në 80-vjetorin e çlirimit të Atdheut nga pushtetuesit nazifashistë u nderua nga Bashkia Mat.*

# Rifat Vani, promovuesi i kulturës dhe dritës në Urakë

**Nga Mimoza CACA**

**R**ifat Vani, i lindur më 12 janar 1935 në fshatin Urakë të rrethit Mat, ishte një nga mësuesit më të njohur dhe të respektuar të këtij rajoni. Gjatë karrierës së tij të gjatë dhe frymëzuese, ai ka luajtur një rol të pazëvendësueshëm në formimin e qindra nxënësve që më vonë u bënë intelektual e kuadro të rëndësishëm të shoqërisë.

Kontributi i tij në fushën e arsimit ishte i jashtëzakonshëm, ku veç të tjerash bashkë me disa koleg të tij krijuan shkollën 8 vjeçare të natës, ku jepnin mësim vullnetarisht për punëtorët dhe fshatarët që ishin me arsim fillor.

Përveç mësimdhënies së përkushtuar, Rifat Vani krijoi grupin e parë artistik të fshatit Urakë, një grup që fitoi famë gjatë viteve 1970-1980. Ky grup artistik u bë një platformë e rëndësishme për zhvillimin dhe promovimin e talenteve të reja, duke e pasuruar kulturën lokale dhe duke e bërë Urakën një qendër të gjallë të veprimtarisë artistike, ku zbuloj edhe dy talentë të rinj të shkëlqyer siç ishin Fatime Cakoni dhe Ded Gjoni të cilët u bënë shumë të njohur në atë kohë, si në rrethet e Matit dhe Mirditës e më gjërë. Ai thoshte gjithmonë, se i kishte ngelur peng që nuk i dërgoi në Festivalin Folklorik të Gjirokastrës, megjithëse fituan në konkurim, konkurrat e kohës i lane jashtë festivalit. Ndërsa mësuesi i nderuar kishte shumë miq, nuk i shfrytëzoi asnjë here për interesa personale, sepse ai gjithmonë kërkonte dhe respektonte vetëm të drejtën dhe të vërtetën.

Një moment historik në jetën e tij ishte edhe viti 1967 siç na e kujton një nga ish nxënësit e tij Luan Gjonaj, një ushtarak i lartë i cili mori mësimet e para nga mësues Rifati. Komandant Luani na kujton se, mësues



Rifat Vani kontribuoi vullnetarisht në elektrifikimin e fshatit. Bile me buxhetin e tij personal, ai ndriçoi rrugën kryesore të fshatit, duke sjellë dritë dhe shpresë në jetën e përditshme të

banorëve. Ky akt bujarie dhe përkushtimi pasqyrojnë më së miri shpirtin e tij altruist dhe dashurinë për komunitetin e tij.

Rifat Vani ishte gjithashtu një di-

zenjator i shkëlqyer dhe një dashamirës i madh i kultivimit të luleve. Kopshtet dhe ambientet e tij ishin gjithmonë të zbukuruara me lule të mrekullueshme, duke sjellë një ndjenjë qetësie dhe bukurie në fshat dhe në shkollë. Përkushtimi i tij ndaj edukimit të brezave dhe shpërndarjes së dijes ishte i palëkundur. Ai veç të tjerash ishte edhe një inisiator dhe organizator i shkëlqyer. Falë inteligjencës dhe formimit të tij intelektual, ai referoi në shumë konferenca shkencore dhe profesionale, duke ndarë njohuritë dhe përvojat e tij me kolegë dhe të rinj të tjerë. Rifat Vani, ka botuar një sërë artikujsh në shtypin e kohës, si dhe ka një krijimtari të gjërë, ku spikat teksti dhe muzika e këngës për liqenin e Ulzës, “Përkundu përkundu ti moj varka ime” etj.

Për kontributin e tij të jashtëzakonshëm në arsimimin, zhvillimin dhe përhapjen e kulturës e dijes, si dhe për qytetërimin e Urakës, Rifat Vani u dekorua me urdhërin e lartë “Naim Frashëri”. Ky nderim është një vlersim i punës dhe kontributit të tij, një dëshmi e respektit dhe mirënjohjes që komuniteti dhe institucionet kishin për të.

Rifat Vani ndërroi jetë më 30 tetor 2023, duke lënë pas një trashëgimi të pasur dhe një shembull frymëzues për brezat e ardhshëm. Ai do të kujtohet gjithmonë si një mësues i përkushtuar, një drejtues i artit e kulturës i talentuar, dhe një qytetar i jashtëzakonshëm që dha gjithçka për zhvillimin dhe përparimin e komunitetit të tij. Në kujtesën e popullit të Urakës dhe më gjërë, Rifat Vani do të mbetet një figurë ndriçuese, një simbol i kulturës dhe i dashurisë për dijen dhe artin.

Pak ditë më pare, në 80-vjetorin e çlirimit të Atdheut nga pushtetuesit nazifashistë u nderua nga Bashkia Mat.

## NJË SHEKULL JETË E PROFESOR NEXHMEDIN MISIRIT

*(Vijon nga faqja 10)*

ji dhe toksikologji veterinarë dhe 15 tema për mbrojtje. Gjithashtu ka bërë oponenca dezertacionesh, tekste, monografi, broshura etj.

Si shkencëtar, është shquar në metodat e eksperimentimit dhe kërkimit e interpretimit shkencor në punën dhe veprimtarinë e tij. Kështu, më 1967 mbrojti dezertacionin me temë: “Studime eksperimentale mbi farmakodinamikën e glikozideve kardiotonike të shpendrës në vendin ton”. Ka kryer studimet: “Efekti fashiocid i një preparati tjetër të tetraklorurit të karbonit”, “Veprimi konservues dhe hemogjenizues i Na EDTA dhe përqëndrimi i plazmës në proteinoterapi” dhe “Harta ekotoksikologjike e vendit tonë” etj.

Por profesori nuk ishte njeri vetëm i auditorit dhe laboratorit, ai dha një ndihmesë të pasqyruar në përcaktimin e rasteve të helmimeve masive në begtori, në të gjithë vendin tonë nga kullotat fushore deri ato alpine.

Problemet e organizimit të farmacie veterinarë ishin një preokupim i profesorit në kushtet e reja të ekonomisë vendit tone. Kështu, jo vetëm hartoi programet, por organizoi edhe kurset e para për përgatitjen e mjekëve veterinarë dhe ndihmoi drejt-

përdrejtë në hapjen dhe funksionimin e farmacie veterinarë, mbi prodhimin e barnave veterinarë, mbi regjistrimin dhe importimin e tyre.

Nga dora e profesor Nexhmedinit, kanë dale dhjetra tekste shkollore si: “Farmakologjia veterinarë” për shkollën e mesme dhe fakultetin, “Farmakologjia për Fakultetin e Mjekësisë”, “Farmakologjia stomatologjike”, “Higjiena e kafshëve bujqësore” etj. Artikuj shkencorë, një seri artikujsh divulgativë. Referime shkencore në sesione të ndryshme në Institutin e Lartë Bujqësor, Institutin e Kërkimeve Veterinarë, Fakultetin e Mjekësisë. Botimet e herepashershme për preparatet veterinarë janë pjesë e aktivitetit të tij botues. Librat “550 receta të mjekësisë popullore”, “Fjali dhe Proverba Latine” janë një pjesë e botimeve të tij.

Në vitin 1971 fitoi titullin “Docent” dhe 1995 titullin “Profesor”.

Profesor dr. Nexhmedin Misiri është vlerësuar nga Qendra Ndërkombëtare e Biografive Kembrixhit në Angli, si njeriu i shquar i vitit 2000.

Unë e konsideroj veten me fat që kam patur mundësi të rri nga afër me profesorin, të bisedoj me të, të mësoj nga profesori, të fitoj sado pak nga metodat e tij studimore. Ai, padyshim është një

nga intelektualët me kulturë të gjërë, ka njohuri në shumë fusha të dijes, është një enciklopedist. Teksa po bisedonim një ditë nga viti 2003 për probleme të feve dhe sidomos asaj islame, më befasoi sa njohuri kishte nga Kurani dhe Hadithi dhe interpretimi i tyre.

Kuranin, më tha profesori, e kam kuptuar më së miri nga leximi në italisht, si gjuhë e pasur gramatikore, pasi përktimi në shqip është i varfër. Dhe pas disa ditësh më solli një studim filozofik të emërtuar “Takim me Zotin”. Studim të cilin e ruaj me fanatizëm dhe në të cilin kuptohet sa njohuri të thella ka profesori në këtë fushë.

Profesor Nexhmedini është i respektuar në të gjitha mjediset, gëzon respektin e kolegëve, ish-studentëve dhe bashkëpunëtorëve. Pamja e tij, fjala e tij e ëmbël përcjellin mirësi, kulturë, thjeshtësi dhe respect për bashkëfolësin. Vitet e fundit profesori jeton në mes Amerikës dhe Kanadasë, duke krijuar boshllëk qenia e tij në ambientet elitare të shoqërisë shqiptare.

Tani, që profesori Nexhmedini po bëhet shekullor, i urojmë akoma plot vite të tjera jetë, të shëndetshme në mes ngrohtësisë së familjes dhe dashamirësisë së miqve të shumtë.

81-VJETORI

# RRUGA E LAVDISHME HEROIKE E BRIGADAVE TË V –të e VI- të SULMUESE

*Formacioni më i madh luftarak i UNÇSH në qarkun e Vlorës*

Brigada e Pestë Sulmuese “Heroinë e Popullit” është formacioni më i madh luftarak i UNÇSH në qarkun e Vlorës, formuar mbi bazën e dy batalioneve partizane “Ismail Qemali” dhe “Halim Xhelo”, si dhe vullnetarëve të rinj që plotësonin radhët. Br.V S është një nga 27 brigadat e Ushtrisë së lavdishme NÇL. Vlen të theksojmë se efektiv i saj përbëhet nga bijtë e bijat më të mira të Vlorës e të Labërisë, luftëtarë të vjetër, ish-partizanë të Çetës “Plakë” të Vlorës, e të shumë njësive të tjera. Fillimisht kishte 3 batalione, me një efektiv të përgjithshëm prej 960 partizanësh. Me një organizim të tillë, Br.V S ishte formuar që më 28 nëntor 1943 në Gumenicë, madje ishte angazhuar në luftime për përballimin e operacionit nazist “Bergkessel” në luginën e Lumit të Vlorës, në dhjetor 1943, ku ra dhe komandanti i parë i Brigadës, Heroi i Popullit Abaz Shehu. Ajo u përrua më 20 janar 1944 në fushën e Bramyshnjës së Tërbaçit dhe përbente një ngjarje me rëndësi të madhe politike-ushtarake. Më 20 janar 1944, Brigada u plotësua me 5 batalione me mbi 1200 partizanë, fillimisht secili me nga 3 kompani. Efektiv i përgjithshëm i Brigadës nga 1200 partizanë në Bramyshnjë, kur po nisej nga Novipazari më 15 mars 1945 numri efektiv i Brigadës arrin 3000 luftëtarë. Brigada kishte 5 batalione me nga 200-400 partizanë dhe në çdo batalion kishte 4 kompani me nga 40-80 vetë. Karakterizohej nga thellësia e veprimeve luftarake në drejtim 2300 km, me temp minimal e maksimal të marshimeve: 20-50 km në ditë, si dhe vazhdueshmëri të marshimeve të sforcuara 3-5 ditë.

Rruga luftarake e Br. V S, e betejave të saj të lavdishme, duket nga vetë luftimet e ashpra e të pandërprera që



ajo zhvilloi prej skajeve jugperëndimore të Atdeut deri tek ato verilindore në Kukës e në Tropojë, në Gjakovë, në Prizren e në Drenicë të Kosovës, madje edhe përtej tyre, deri në Sanxhak e në Bosnjën Jugore. Luftimet e saj, si ato për thyerjen e operacioneve naziste në dimrin e viteve 1943-44 në Zonën I

Operative Vlorë-Gjirokastrë, ato të Sevasterit, të Kuçit e të Borshit në mars e në prill të vitit 1944, të Çarshovës e Biovizhdës së Përmetit në maj, të Qafës së Gjarpërit e të Gurit të Prerë gjatë thyerjes së Mësymjes armike të Qershorit 1944; kalimi i Shkumbinit dhe luftimet në Shupal të Tiranës, në Macukull e

Klos të Matit, në Sinë e Korab të Dibrës, në Lumë të Kukësit, në Gjakovë e Prizren dhe në malet me borë të Sanxhakut, do të kujtohen gjithnjë si beteja, ku është derdhur shumë gjak trimash të kësaj njësie partizane kundër një armiku të madh, të egër, të fuqishëm dhe të armatosur gjer në dhëmbë.



Lavdi Brigadës së VI-të Sulmuese, e cila me kontributin e saj të vyer në luftën për çlirimin e atdeut u quajt “Heroinë e Popullit”. Brigada e 6-Sulmuese u krijua në Përmet më 26 janar 1944 në kulmin e operacionit armik të dimrit. Ishte e para brigadë partizane në Qarkun e Gjirokastrës dhe në përbërjen e saj u rreshtuan batalione partizane të këtij qarku, të cilët ishin sprovuar në fushën e luftës dhe kishin fituar një përvojë të madhe.

Më 26 janar 1944, ditën e formimit

u rreshtuan në Përmet batalioni “Asim Zeneli”, “Abaz Shehu”, “Naim Frashëri”, “Baba Abaz” e më vonë, kësaj brigade iu shtua edhe batalioni V “Zaho Koka” me djem e vajza nga bregdeti. Në ditët e formimit, brigada kishte 912 partizanë, 120 shoqe, 60 pionerë.

Në kohën e krijimit të brigadës ishin këta kadro: komandant brigade-Tahir Kadareja, nënkomandant-Jaho Gjoliku, komisar-Mustafa Mato-hiti, zëvendëskomisar-Haki Toska. Në seksionin politik shokët Adil Çarçani, Zihni Sako,

## BRIGADA E GJASHTË I DHA ATDHEUT 203 DËSHMORË

Sami Gjebero, Siri Çarçani, Vangjelo Sotiriadhi, itedentë të brigadës-Hetem Pogaçe e ndihmës Braho Toto, për shëndetësinë-Nedin Kalanxhi, (ndihmësmjek), për ndërlihdjen-Muhedin Bakiri; komandant batalionesh: - Riza Veipi, Sadik Buzo, Fejzo Ismaili, Feti Bubsii e më vonë, komandant i batalioni V-Maksut Myrtaj, si dhe nënkomandantë batalionesh: -Astrit Nishani, Musa Daci, Mustafa Asllani, Meleq Gostinshiti, zëvendëskomisar batalionesh-Ago Çeli, Veledin Zeneli, Abdul Hakiu, Mitro Khani, Asaf Dragoti, Petrit Radovicka etj. Luftëtarët e brigadës ishin të armatosur me armë të ndryshme trofë, që ia kishin rrëmbyer armikut. Efektiv i kishte 595 pushkë italiane, 80 pushkë gjermane, 41 pushkë greke si dhe disa pushkë angleze, automatikë italianë e gjermanë, mitralozë të lehtë e të rëndë, 16 murtaja të lehta 45 mm, dy topa 45 mm dhe dy topa 75/13. Gjithashtu, në brigadë ishte dhe bateria e artilerisë.

Ajo përshkoi një rrugë të gjatë luftarake ku dhanë jetën 203 dëshmorë nga të cilët 10 heronj të popullit. Sakrificat e saj ishin të panumërta, kontributi i saj ishte i madh në çlirimin e disa qyteteve dhe krahinave të vendit. Në luftimet e zhvilluara spikati gjithmonë guximi dhe trimëria. Rruga luftarake e saj ishte e lavdishme dhe heroike.

Sot pas 81 vjetësh në përkujtim të kësaj dite historike me krenari shprehim respektin dhe mirënjohjen për të gjithë ata që u angazhuan në këtë luftë të rëndësishme për lirinë e vendit. Kjo ditë ishte zanafilla e realizimit të shumë ëndrravë për atdeun tonë me sakrificat e së djeshmes dhe punën e sotme për të ecur përpara në rrugën e progresit dhe zhvillimit duke u përpjekur për të bërë më të mirën për qytetin tonë dhe të ardhmen e tij europiane. Natyrisht duke vazhduar të kujtojmë me respekt të gjithë ata që e deshën atdeun aq shumë duke dhënë jetën për të.

**DOSSIER**

*Zyrtarisht shkolla në Viçisht u hap me 28 dhjetor 1944, një muaj pas çlirimit të Shqipërisë*

# 80 - vjetori i shkolles 8 - vjeçare të Viçishtit të Dibrës



**Nga Emin Cami**

- *Shkolla 9 vjeçare e Vicishtit që mban emrin e dëshmorit të Atdheut Fasli Cami, feston 80 vjetorin e saj, por e kërcënuar nga mbyllja për shkak të largimeve të nxënësve, nga largimet e banorëve të fshatit dhe të zonës. Shpresojmë që kjo të mos ndodhë, që kjo shkollë të rritet e të forcohet, pasi ka një histori të lavdishme*



Tërbaç jepnin mësim Vesel Shabani dhe Tahir Velija.

Në klasën e tetë erdhi një tjetër mësues nga ky fshat, Fehmi Lika, që më vonë do të bëhej një nga drejtuesit më jetëgjatë të kësaj shkolle.

**NGA DITARI IM I ATYRE VITEVE**

Duke parë nivelin e ulët të kuadrove dhe bashkëfshatarëve të mi u hap shkolla 8 vjeçare e natës, ku paralel me klasën e pestë ditën, jepja mësim edhe në klasën e pestë të mbas ditës. E filloja mësim fill mbasditë që të mbaroja pa na zënë nata sepse ishte malësi dhe zonë e ftohtë, bënte dimër i jashtëzakonshëm. Njerëzit më donin dhe më respektonin. Mësuesi ishte figurë e dashur dhe e repektuar. Ne mësuesit nga ana jonë punonim fort. Jepnin shpirtin tonë në mësimdhënie.

Gëzimi më i madh ka qenë si mësues dhe drejtor shkolle ka qenë provimi i lirim-it me nxënësit të parë dhe me ato kuadrot dhe bashkëfshatarët e mi, që ndonëse ishin më të moshuar më respektonin më shumë se fëmijët e tyre.

Pas përfundimit të Institutit fillova punë direkt në fshatin tim, Viçisht i Dibrës, sot Bashkia e Bulqizës dhe isha i pari mësues në ciklin e lartë dhe drejtues i parë i shkollës 8 vjeçare të këtij fshati, shkollë që tanimë ka një histori 80 vjeçare.

Në vitin 1971 Emimi thirret për të kryer shërbimin ushtarak. Forcat e Armatosura e pikasën aftësinë dhe talentin e tij dhe e mbajtën si kuadër të Forcave të Armatosura për 19 vjet më rradhë. Ai ka kryer detyra të rëndësishme në ushtri.

Pas largimit për të kryer shërbimin ushtarak, vendin e Emin Camit si drejtor shkolle e mban e shoqja e tij, Lirije Cami, e bija e Veli Zogut, që vinte nga Kruja, me arsim të lartë dhe me përvojë të madhe. Ajo shërbeu edhe 4 vjet të tjera si drejtoreshë shkolle duke lënë gjurmë me punën e saj pasionante.

Pas transferimit për në Peshkopi të Emimit dhe Lirijes, drejtor shkolle erdhi Nazif Sulku. Në vitin 1979 drejtor shkolle ishte Rustem Murrja. Rustem Murrja banonte tek Fisi Xheka në një shtëpi ku personat ishin larguar. Në ciklin e ulët (shkollën fillore) jepnin mësim Destan Cami, Beqir Mera, Rakip Krrusa dhe Zurië Murrja. Në ciklin e lartë 8 vjeçar jepnin mësim: Fisnik Manjani jepte lëndën e gjuhës dhe letërsisë shqipe, historisë etj, Bashkim Lila jepte biologji, kimi etj, Festim Kola jepte matematikë, fizikë etj., Fadil Cami jepte fiskulturë, gjeografi etj. Unë isha edukatore kopështi dhe punova tre vjet.

Në vitin 1984 drejtor shkolle ka qenë Avni Mera. Bashkëshortja e Rustemit, Zurië Murrja ishte edukatore kopështi.

Në ciklin e ulët jepnin mësim Merjeme Cami, Destan Cami, Fehmi Lika dhe Rakip Krrusa.

Në ciklin e 8 vjeçares punonin Festim Kola, Bashkim Lila, Fisnik Manjani dhe Fadil Cami. Në këtë periudhë është bërë edhe ndërtimi i shkollës së re dy katëshe që ju vu emri i dëshmorit të fshatit, mësuesit të parë dëshmor Fasli Cami.

E pranishme në ceremoninë e përmimit të shkollës ka qenë Ministria e Arsimit dhe Kulturës, bija e këtij fshati, Tefta Cami.

Shkolla 9 vjeçare e Vicishtit feston 80 vjetorin e saj, por e kërcënuar nga mbyllja për shkak të largimeve të nxënësve, nga largimet e banorëve të fshatit dhe të zonës. Shpresojmë që kjo të mos ndodhë, që kjo shkollë të rritet e të forcohet, pasi ka një histori të lavdishme.

Studna ku jepte mësim dhe shërben në Viçisht derisa doli në pension.

Në vitet e para një mësues bënte mësim në 4 klasa kolektive, ku klasa e parë kishte 18 nxënës, klasa e dytë, 10 nxënës, klasa e tretë, 8 nxënës dhe klasa e katërt 10 nxënës, në total 46 nxënës. Pas vitit 1960 një mësues jepte mësim në dy klasa kolektive, e para dhe e treta, njëri mësues dhe e dyta dhe e katërta jepte mësim mësuesi tjetër. Njëri kishte përgjegjësinë e klasës së parë dhe tjetri përgjegjësinë e provimeve të lirim-it të klasës së katërt.

Në vitin shkollor 1967-1968 u hap për herë të parë klasa e pestë dhe pas një viti u hap klasa e gjashtë.

**VITET KUR U HAPËN SHKOLLA E PARË 8-VJEÇARE DHE E MESME. KUJTIMET E ISH DREJTORIT AVNI MERA**

Shkolla e parë 8 vjeçare në Viçisht është hapur në vitin 1968 me mësues dhe drejtor të parë Emin Camin. Në vitin 1972 drejtoreshë u bë bashkëshortja e Emimit, Lirije Cami, pasi Emimi kaloi si oficer në shërbimin aktiv. Në vitin shkollor 1968-1969 shkolla e Viçishtit kaloi me drejtorin më vete. Drejtor i parë u emrua Emin Cami. Hapja e shkollës 8 vjeçare krijoi mundësinë e regjistrimit edhe për shumë fëmijë të zonës së Gollobordës.

Për rreth 20 vjet kjo shkollë funksionoi si shkollë 8 vjeçare. Për të vazhduar shkollën e mesme kishte tre mundësi: të merrje bursë shteti, të vazhdoje shkollën në Shupenzë ose tek ndonjë i afërm që banonte në qytet. Vazhdimi i shkollës së mesme në Shupenzë në kushtet e mungesës së transportit ju kushtonte nxënësve katër orë rrugë në këmbë njëloj si dikur nxënësit e shkollës 8 vjeçare shkonin në këmbë në Gjoricë.

Në kujtimet e tij ish drejtor i kësaj shkolle Avni Mera shkruan: “Me mbështetjen e ministres së arsimit znj. Tefta Cami, në fshatrat Viçisht dhe Gjoricë në vitin 1985 nisi ndërtimi i shkollave të reja të cilat u inaguruan në vitin 1986. Me kërkesën e banorëve të fshatit Viçisht dhe dëshirën e ministres së arsimit për të kontribuar në arsimimin e banorëve të fshatit Viçisht, ku ajo lindi dhe u rrit si dhe zonës për rreth, në vitin shkollor 1986-1987 u hap arsimiti i mesëm. Bindja ime e hershme për banorët e fshatit Viçisht si njerëz të besës, punës, mikpritjes dhe vullnetit për shkollim u provua kur hapi dyert arsimiti i mesëm i përgjithshëm në këtë fshat të thellë por me shumë traditë. Nuk mund të harroj përpjekjet e vazhdueshme të njerëzve arsimdashës të këtij fshati për të mbështetur punën e mësuesve të kësaj shkolle dhe mua si drejtor shkolle”.

Në shkollën e mesme u regjistru-

an 40 nxënës në vitin e parë. Në këtë shkollë u regjistruan edhe shumë nxënës nga Çerencit, Lubaleshi, Tërbaçi, Sepetova, Mireshi, Pasinka etj.

Pas vitit 1990 për shkak të lëvizjes së popullsisë drejt qendrave urbane si Peshkopi, Bulqize, Durrës, Tiranë etj u mbyll shkolla e mesme dhe ndërkohe bie shumë edhe numri i nxënësve të shkollës 9 vjeçare. Në vitin shkollor 2004 - 2005 drejtorisë së shkollës Viçisht i bashkangjitet dhe shkolla e fshatit Lubalesh për shkak të rënies së numrit të nxënësve në këtë fshat. Në vitin 2007 hapet për herë të parë shkolla fillore e Çerencit të Epërm, shkollë e cila i kaloi edhe kjo në varësi shkollës së Viçishtit.

Në këto 80 vjet histori të shkollës së fshatit Viçisht kanë punuar dhe kontribuar me qindra mësues. Shumë prej tyre kan punuar jo vetëm në shkollën e Viçishtit por edhe në disa shkolla të zonës së Gollobordës si Pasinkë, Lladomericë, Tuçep, Ostren, Klenjë, Llangë etj. Disa drejtues shkolle në vite kanë qenë Emin Cami, Lirie Cami, Xhavit Sulku, Rustem Murrja, Avni Mera, Dritan Ramizi, Fisnik Manjani, Rushit Suma, Femi Lika, Idriz Mera, Ajat Suma, Xhevrie Cami, Lirije Gjura Teodori etj. Po kështu shumë ish nxënës të kësaj shkolle kanë vazhduar studimet e shkollës së mesme dhe studimet e larta. Disa prej tyre kanë marrë edhe grada shkencore. Nga kjo shkollë kanë dalë deputetë e ministra.

Deri në vitin 1969 shkolla fillore e Viçishtit varej nga drejtoria e shkollës 8 vjeçare Gjoricë me drejtoreshë Bukurie Kaja (Lleshi).

Në vitin shkollor 1967-1968 u hap për herë të parë klasa e pestë. Mësuesi i klasës së pestë u caktua Emin Cami, biri i këtij fshati, që sapo kishte përfunduar studimet në Institutin Pedagogjik të Shkodrës. Ai zhvillonte të gjitha lëndët, megjithëse kishte mbaruar studimet për gjuhë dhe letërsi.

Më 30 nëntor 1967 ndodhi një tërmet i fuqishëm. Shkolla e vjetër u shemb. Me kontributin vullnetar të fshatarëve, mësuesve e nxënësve dhe me ndihmën materiale të shtetit u ndërtua shkolla e re. Pas një viti u hap klasa e gjashtë. Mësues erdhi Fiqiretë Lila. Lëndët i ndanë në të dy klasat në mënyrë të barabartë. Në ciklin e ulët jepnin mësim Rexhep Lika dhe Ferit Gugushi.

Në vitin shkollor 1969-1970 shkolla e Viçishtit kaloi me drejtorin më vete dhe drejtor i parë u emërua Emin Cami. Filloi edhe klasa e shtatë dhe shkolla mori fizionomi të plotë. Erdhën si mësues Hashim Suti, Liljana Skuka dhe Fatmira Skuka. Hapja e shkollës 8 vjeçare krijoi mundësinë e regjistrimit edhe për shumë fëmijë të zonës së Gollobordës.

Shkolla fillore e Tërbaçit kaloi në vartësi të Shkollës 8 vjeçare të Vicishtit. Në

## LIBRI

Analiza e të gjitha ngjarjeve historike të ndodhura në shekuj zë një vend nderi në historinë e qytetit të Pukës

# Xhemal Meçi, qëndron stoik mes maleve të Pukës

Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj

## NJË JETË PËR HISTORINË E PUKËS

Ditë më parë Mjeshtëri i Madh Xhemal Meçi nga Puka më dërgon librin "Na ka çue Shkodra ni fjalë", si "kujtim e respekt për shkrimet për dëshmorët e Atdheut, si dhe për Pukën". Libri është një përmbledhje artikujsh historik e për ngjarje që lidhen me Pukën dhe historinë rreth saj.

Autori në libër pasi bën një hyrje dhe një prezantim të librit dhe të shkollës e të studimeve të tij, të mjaft peripeçive të kaluara në jetë, na paraqet ngjarje historike që lidhen me të kaluarën e lavdishme të popullit tonë.

Vendin kryesor në libër e zë përkuajtimi i 110 vjetori i Luftës së Shkodrës kundër ushtrive pushtuese serbo-malazeze gjatë rrethimit barbar 7-mujor, nëntor 1912-prill-maj 1913. Për Luftën e Shkodrës Akademia e Mbrojtjes dhe Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi" në vitin 2008 zhvilluan një sesion shkencor me objekt "Luftërat ballkanike dhe Shqipëria", botuar dhe libër, e studion mirë problemin nga ana ushtarake. Por Xhemal Meçi e ka trajtuar një një kënd tjetër, atë të "malet Pukë-Mirditë në mbrotje të shkodrës së rrethuar nga ushtritë pushtuese serbo-malazeze (1912-1913)" si dhe "mbrojtja e Shkodrës, kundër ushtrisë pushtuese serbo-malazeze (nëntor 1912-prill-maj 1913) në poezitë e rapsodit Prendush Gega "artist i merituar".

Në vijim autori ka trajtuar tema historike si: "Nora" e Mirdits, marshterpa e Spaçit, shek. XVI, "Ymer Prizreni", "Me rastin e 100 vjetorit të varjes (18 gusht 2010), homazhe te varri dhe pllaka përkujtimore kushtuar atdhetarit Haxhi Rustë Kabashi", "Shqiptarët, një komb unik, si kurrë ndonjëherë në historinë tonë kombëtare", "Cili ishte atdhetari Haxhi Rustë Kabashi i Prizrenit", "Si qëndron e vërteta e origjinës dhe e vendlindje së Dhimitër e Nikollë Berishës?", "zeneli ishte vet historia dhe ndërgjegjia kombëtare kosovare shqiptare", "Piktori Abdurrahim Buza puthi në Puke për herë të parë flamurin kombëtar shqiptar (1922)", "Recitohen "vaje" nga Lahuta e Malëcisë e Fishtës në provim shteti, Instituti i Lartë Pedagogjik, Tiranë, qershor, 1968", si dhe "Legjenda dhe burime për shqiponjën e zezë dykrenare".

Në pjesën e dytë të librit autori është përqëndruar në shkrimet për vendlindjen e tij, të tilla si: "Puka, një qytet i bukur turistik malor", "Abacia e Shën Palit të Pukës, Grykë-Kabash, 1440 vjetori e saj", "Hafiz, Haxhi Hysen Ismail Muçaj, personalitet i shquar islam", "Mbresa për 50 vjetori e Kongresit të Drejtshkrimit të gjuhës shqipe", "Profesor E. Çabej në Kabash të Pukës për sesionin shkencor për toponimet, Kabash, 21 maj 1977", "Prof. dr. Eqrem Zenelaj, "Kalorës i urdhërit të Skënderbeut", "Jeronim de Rada për toponiminë historike shqiptare", "Pal Dede Bajraktari", "Iballa Simbas Hanit, albanolog i shquar në bot-

imin, udhëtim nëpër viset e Drinit e të vardarit, 1863", "Migjeni në Pukë", "Petro Zheji, shqipja është mëma e të gjitha gjuhëve" dhe "Mentor Quku".

Analiza e të gjitha ngjarjeve historike të ndodhura në Pukë në shekuj zë një vend nderi në historinë e qytetit të Pukës, por dhe një krenari që Xhemal Meçi e ka nxjerrë në dukje në shkrimet e tij. Janë shkrime që kanë vlera njohëse, por dhe të trajtuara shkencërisht e të vërtetuara nëpërmjet një dokumentacioni të pasur.

## NË RRUGËN E JETËS SË VËSHTIRË

Xhemal Maçi ka lindur në Kabash Pukë më 23 korrik 1936. Shkollën Unike (7 vjeçare) e kreu në Pukë. Pas kësaj, ka bërë përpjekje për të përfunduar sa me shpejt dhe me sukses Shkollën e Mesme Pedagogjike "Shenjaze Juka" në Shkodër. Ai kishte përfunduar një kursin pedagogjik në muajt qershor-korrik 1953 për mësues. Shkollën donte të fillonte me korespondencë me qëllim që të arrinte të hynte në maturë sa më shpejt, pasi mund ta merrnin ushtar për disa kohë.

Me besim te profesorët e Shkollës Pedagogjike, por sidomos tek nëndrejtori Dedë Shala, që Xhemali e quan "shpirt njeriu, aq komunikues dhe i gatshëm për përkrahjen e arsimit me korespondencë", hyri me vendosmëri në provimeve në janar 1954. Në lëndën e kimisë nuk i eci mbarë, pasi u paraqit për provim tri herë në të njëjtin vit shkollor e në të njëjtën lëndë. Ishte kjo një rregullore që Xhemalin e kishte nevikosur shumë. Sekretaria e shkollës e përcolli me buzë në gaz me një "mirëardhësh si përsëritës në sesionin e janarit 1955".

Por Xhemali, me një betim bazuar dhe në sedrën e malësorit të lënduar, e përsëriti vitin e parë brenda gushtit 1955 dhe do të përfundonte edhe vitin e dytë dhe të tretë që të hynte në vitin e katërt në janar 1956! Duke treguar se ç'bën sedra e një malësori të lënduar, por edhe kur gjeti përkrahje bujare e humane te personelt pedagogjik i shkollës, arrit sukses duke shënuar ratin e papërsëritshëm që në shkollën pedagogjike "Shenjaze Juka" në Shkodër me korespondencë për një vit dhjetor-gusht 1955 të merrte tri klasë (te paren si perserites, kurse te dyten e te treten brenda sesioneve te provimeve prill-gusht 1955. Këmbëngulja dhe sedra për t'u përgatitur seriozisht, arriti t'u bënte konsultime mësuesëve të tjerë. Kështu profesori i matematikës Tomorr Dani e lejonte që në dërrasë të zezë të zhvillonte ushtrime e probleme për mësuesit që kishin ardhë për konsultime me profesorin. Ai e repektonte dhe para mësuesve dhe pedagogëve për seriozitetin në përgaditjen e lëndëve për provim. Në këtë kohë Xhemal Meçi merr vlerësime nga shtypi i kohës, si nga gazeta "Bashkimi" me shkrimin "Mësues shembullor fshati", ku theksohet se "mësuesi i malësisë kreu me sukses klasën e parë, të dytë, të tretë pedagogjike me korespondencë duke dalë me nota të mira". Ndërsa gazeta "Rinia" në shkrimin "Njeriu me vullnet



të fortë"... e quajnë Xhemal Meçi.

Atë që e dallonte më tepër këtë të ri ishte këmbëngulja për t'ia arritur qëllimit. Ai kishte bërë vetëm shkollën 7 vjeçare si nxënës i ditës, të mesmen e bëri me korespondencë në pedagogjiken e Shkodrës brenda dy vjetëve. Kjo ishte e habitshme, por vullneti i Xhemalit bëri të pamundurën. Me korespondencë ai mbaroi dhe Institutin e Lartë Pedagogjik në Tiranë, e në vazhdim përfundoi dhe Fakultetin 4-vjeçar Filologji-Histori. Një njeri i tillë, me vlera pa dyshim që ishte dhe një edukator shembullor i brezit të ri. Ai në jetë diti të edukojë nxënës me vullnet, që ishte vetia kryesore për të kryer qëllimin në jetë...Sot nga mosha e viteve, por dhe e ndjenjës së respektit për mësuesit Xhemali i kujton me respekt edhe personelin e Shkollës Pedagogjike Shkodër, të cilët morën vendim për të bërë kërkesë për rezultate ekselencë të shkojë me bursë në Bashkimin Sovjetik. Nga Ministria e Arsimit u dërguan tri bursa për studime pedagogjike në Moskë, për Xhemal Maçi, Kolë Tahirin dhe Murat Gecin nga Troproja. Xhemali e refuzoi për shkaqe gjoja ekonomike, pasi ai kishte shkaqe politike, pasi një dajë i tij ishte i dënuar me burg politik. E kështu vazhdoi që drejtorja e shkollës duke i kërkuar ministrit gjashtë bursa (ndër ta dhe për Xhemali) për në Institutin e Lartë Pedagogjik në Tiranë për gjuhë-letërsi e histori në vitin 1959, si stimuj e nxitje për mësuesit me korespondencë. Ishte një kohë tjetër e që për një fjalë goje të mos mirrje atë që të takonte...

Deri me 1967 nuk ishte vendosur ende kriteri politik për shkollën e natës të korespondencës, me këtë hapësirë vazhdoi Fakultetin Gjuhë-Letërsi në UT. Në vitet 1960-1962 shkon ushtar në Brigadën e Durrësit, me qëndrim në garnizonin e Kavajës. Prej këtu me tren mbrinte në Tiranë për konsultime e provime. Kishte shokë që nuk besonin dhe nuk kuptonin në këtë sakrificë (ushtarë, student me gjithë shërbi-


min ushtarak. Ai mbaroi dhe shërbi-min ushtarak me vlerësimin "Ushtarë shembullor" dhe u pajis me librezë të veçantë... ishte vullneti për dije i një të riu të kohës...

## KONTRIBUTE PËR ORGANIZATËN E DËSHMORËVE

Dega e Organizatës Kombëtare për Dëshmorët e LANÇ-it dhe Dëshmorët e tjerë të Atdheut, të bashkisë Pukë, në vijimësi ka bërë kujdes dhe ka organizuar simpoziume me temë "Dëshmorët e Atdheut në rrethin tonë". Në simpoziumin e vitit 2023 historiani dhe shkrimtari Xhemil Meçi "Të rënë që meritojnë të shpallen "Dëshmorë të Atdheut" në rrethin e Pukës dhe plotësimi i dokumentacionit". Diskutimin historian e përqëndroi duke theksuar se "Puka, burrat dhe gratë e saj gjatë gjithë historisë të zhvillimit të tyre janë ndeshur në luftëra dhe përpjekje të vazhdueshme për të jetuar të lirë dhe krenarë në atdheun e tyre. Këtë e dëshmojnë mjaft luftëra të zhvilluara si në rrethinat e Pukës, por dhe ashtu kur i ka thërritur mëmëdheu dhe janë gjendur pranë vëllezëve të tyre në malësinë e Shkodrës, të Rrafshit të Dukagjinit, të Kosovës, të Mirditës, të Shkodrës, në LANÇ, në ndërtimin e Shqipërisë dhe të demokracisë në Shqipëri në shek. XXI.

Vëmendjen historiani e përqëndroi në problemin për të rënë që meritojnë të shpallen "Dëshmorë të Atdheut" në rrethin e Pukës dhe detyrat tona për plotësimin e dokumentacionit". Për t'u shpallur dëshmorë të Atdheut ligji 109/2018 "Për statusin e dëshmorit të atdheut" i përcakton mjaft qartë dokumentacionin që duhen plotësuar nga pjesëtarë të familjeve, shoqata, institucione etj. Dokumentacioni në bazë të ligjit, neni 8 thekson se "Për shpalljen "Dëshmor i atdheut" vlejën si burime parësore dokumente të organeve publike, të krijuara në kohën e ngjarjes dhe, si burime dytësore, botimet me

## PROFILI



## MARGARITARË ANALITIKË PËR SHPENDIN

Doli këto ditë nga shtypi libri "I palodhuri Shpendi, shkrimtari, njeriu" botim i shtëpisë botuese 2M. Është libri i pestë që shkruhet për veprën poliedrike të këtij shkrimtari të palodhur që kontribuon në kulturën shqiptare.

Për Shpendin janë shkruar këta libra: "Të shkruar në liri", "Liria e të shkruarit", "Kur mendja bashkohet me zemrën", "Shpendi Topollaj, Nje shkrimtar i çuditshëm", dhe ky që më i fundit "I palodhuri Shpendi, shkrimtari, njeriu".

Nuk është pak të shkruhen pesë libra për një autor, nuk është pak që edhe në librin e fundit "I palodhuri Shpendi, shkrimtari, njeriu" janë me dhjetra autorë me zë që shkruajnë mbi vlerat e veprës së Shpendi Topollajt.

Libri nbahet në dy pjesë ku pjesa e parë përbëhet me analiza dhe persiatje, ndërsa pjesa e dytë ka mesazhe të marra në kohë të ndryshme, duke filluar nga i madhi Ismail Kadare e deri te Teuta Vinca.

Vlen te citoj shprehjen e mikut tim, Mjeshtër të Madh Halil Rama se çfarë shkruan për Shpendin:

"Kudo ai shfaqet si një intelektual i përgjegjshëm, predikues i vlerave tona kombëtare, i dashurisë për Atdhe dhe marrjen e fateve të tij në duart e vetë shqiptarëve".

I urojme udhë të mbarë këtij libri plot me margaritarë analitike për Shpend Topollajn!

Fatmir MINGULI

# "I palodhuri Shpendi Topollaj, shkrimtari, njeriu"

•HALIL RAMA – Mjeshtër i Madh: "Kudo ai shfaqet si një intelektual i përgjegjshëm, predikues i vlerave tona kombëtare, i dashurisë për Atdhe dhe marrjen e fateve të tij në duart e vetë shqiptarëve".

## I PALODHURI DHE DINJITOZI....

E kam shprehur disa herë se ndihem krenar që kam një mik si shkrimtari i të gjitha gjinive Shpendi Topollaj. I kam kushtuar atij edhe dy poezi, por këto kanë qenë pak, shumë pak për të treguar konsideratën time për vlerat e larta të tij, si në planin njerëzor dhe atë intelektual, ashtu edhe në fushën e krijimtarisë së jashtëzakonshme letrare. Kur mësova se po botohej volumi i pestë kushtuar jetës dhe veprës së tij, kërkova me ngulm që parathënia të më besohej mua. E quaj këtë një nder për atë që di të nderojë dhe vlerësojë si askush tjetër, krijimtarinë e kolegëve të njohur e të pa njohur. Edhe titulli i librit është një propozimi im. Për Shpendin vlen të kujtohet ai epitafi i famshëm te varri i Nikolo Makiavelit: "Tanto nomini nullum par elogium" që në shqip do të thotë se "Për një emër të tillë asnjë lavdi nuk është e barabartë". E bëj këtë përqasje edhe pse e di fare mirë dallimin e tij me autorin e djallëzuar të "Sundimtarit" - t i cili këshillonte që për arritjen e qëllimit, nuk duhen marrë parasysh mjetet. Shpendi, me ndershmërinë e tij karakteristike është antipodi i tij. Shumë epitete i kanë kushtuar atij, por unë mendova ta quaj këtë përmbledhje thjesht "I palodhuri Shpendi Topollaj". I palodhuri dhe dinjitozi Shpendi Topollaj. E them këtë, pasi e kam parë që kur i kanë dhuruar një roman, jo vetëm që e ka lexuar atë me një frymë, por edhe i ka bërë analizën për ta botuar në ndonjë gazetë a portal. E them këtë, pasi e kam ndjekur nga afër organizimin e promovimit të librave të pafund, duke siguruar gjithçka duhet për mbarëvajtjen që nga sallat e deri te lajmërimet e auditorit. I kam lexuar ato në plot tridhjetëepesë libra të tij me kritika letrare, çka besoj se është një rast i rrallë në historinë e letërsisë tonë. E them këtë, pasi kam

parë se ai gjithmonë, madje edhe kur ka qënë i sëmurë, nuk u ka thënë jo, të gjithë atyre që i kanë kërkuar t'u mbajë fjalën kryesore, si në qytetin e tij Durrës, ashtu edhe në qytete të tjera, pa harruar edhe shtete të tjera, si Kosovë, Maqedoni e Veriut apo Greqi. E them këtë, pasi ai nuk ka reshtur së shkruari e botuari rreth tetëdhjetë libra artistikë (disa në gjuhë të huaja), ku veç kritikave letrare, ka lëvruar me sukses të plotë, romanet, novelat, tregimet, poezitë, publicistikën, esetë, epigramet, aforizmat e deri dramet. E them këtë, pasi ai për asnjë çast nuk ka reshtur së ngrituri zërin e pabesueshëm, në mbrojtje të çështjes sonë kombëtare dhe veçanërisht të domosdoshmërisë së bashkimit kombëtar. E them këtë, pasi ai nuk i ka kursyer qortimet e tij të mprehta dhe të rrepta si për politikën tonë nënshtruese ndaj të huajve, ashtu edhe ndaj vetë hileve që këta të fundit manifestojnë ndaj shqiptarëve e sidomos ndaj vëllezërve tanë kosovarë, duke kërkuar t'i bëjnë lëshime pas lëshimesh kriminelëve serbë. E them këtë, kur kam parë se ai me burrëri e ktheu mbrapsht çmimin e madh "Pushkin" akorduar nga Lidhja e Shkrimtarëve dhe Artistëve të Rosisë, kur ky vend sulmoi mizorisht e pabesisht popullin e Ukrainës. E them këtë kur e shoh se ai të gjithë librat e botuar me sakrificë të mëdha ekonomike, ua dhuron shokëve dhe miqve të shumtë si dhe bibliotekave anë e kënd Shqipërisë. E them këtë, teksa jam dëshmitar i nxitjes dhe përkrahjes që ai u bën autorëve të ndryshëm, duke ua korrigjuar, redaktuar apo shkruar parathëniet librave të tyre. E them këtë ngaqë e shoh se si përhap dije dhe kulturë në çdo takim me nxënësit e shkollave. E them këtë edhe ngaqë asnjëherë, me gjithë këmbënguljen e punonjëseve të Bibliotekës dhe miqve të tij shkrimtarë, nuk ka pranuar

t'i promovohen librat e tij. E them këtë edhe për faktin se ai është drejtues energjik i disa shoqatave në rang rrethi e kombëtare si ajo "Skënderbegasi" Nderi i Kombit, OBVLP, Federata e Paqes Universale, Dega Durrës, etj. E them këtë se është një familjar i përkushtuar si pakkush. Por mbi të gjitha, e them këtë pasi Shpendi Topollaj, është mik me të gjithë, i thjeshtë, i dashur me këdo dhe gjithmonë gojëmjaltë e bujar. E them këtë edhe pse ai për asnjë çast nuk e hoqi nga mendja dhe zemra e tij ushtrinë, ku pas shkollës "Skënderbej" dhe asaj të Oficerëve shërbeu për një kohë të gjatë, ku mori gradën kolonel dhe la kujtimet e një njeriu dhe kuadri model. Por nuk mund të rri pa thënë se edhe pse punoi për rreth njëzet vjet në organet e drejtësisë, përsëri, jeton në një apartament prej pesëdhjetë metrash katrore. Personalisht, jam miqësuar me të vitet e fundit dhe më vjen keq që kjo ndodhi kaq vonë. Megjithatë, duhet të pranohet se më duket sikur e kam pasur përkrah këtë njeri korrekt e të sinqertë gjithë jetën. Këtë njeri që edhe pse i bënë padrejtësi dhe e ndëshkuan pas babait të tij, partizanit trim Hulësiut, përsëri nuk shfaqti asnjëherë ndonjë ndjenjë hakmarrjeje për askënd. Këtë njeri, shok e mik që më përkrahu pa rezerva që të nisja rrugën e bukur të shkruarjes dhe botimit të poezive, pikërisht kur fati më solli disa fatkeqësi dhe kisha nevojë të shprehesh. Këtë njeri që na bashkonte fakti që kishim kaluar të njëjtat vështirësi e peripeci në reparte të ndryshme të ushtrisë, për mbrojtjen e Atdheut tonë të shtrenjtë. Sa shumë kisha për të thënë, por po e ndërpres këtu fjalën time, se m'u kujtua Volteri që thosh: "Të gjitha nderimet e kësaj bote nuk vlejnë për një mik të mirë". Dhe si për t'i vërtetuar fjalët e mia, sapo e përfundova këtë shkrim, Shpendi u zgjodh njëzëri Kryetar i Federatës së Paqes Universale në Durrës. Si unë folën për të edhe Ambasadorët për Paqe, intelektualë dhe personalitete nga më të shquarit....

BAJRAM SULEJMANI

## Xhemal Meçi, qëndron stoik mes maleve të Pukës

karakter historik, folklorik, publicistik e manuale biografike, të cilat shprehen për ngjarjen, vlejën dekretet/vendimet e organeve shtetërore të mëparshme për shpalljen "Dëshmor". Plotësimi i tyre kërkon punë, vullnet, durim dhe përpjekje për sistemim të tyre.

Theksoi se nga shoqata e Historianëve Ushtarakë të Shqipërisë janë propozuar për t'u shpallur dëshmorë At Shtjefën Gjeçovi (Mëhill Gjeç-Kryeziu/At Shtjefën Kostandin Gjeçovi veprimtar i lëvizjes kombëtare shqiptare, frat françeskan, etnolog, arkeolog, poet e shkrimtar i spikatur, filozof, përhapës i shkollave shqipe në Shqipërinë e këtij Drinit dhe matanë Drinit, "Mësues i popullit", inisiator për unifikimin e gegërishtes me toskërishten, mbrojtës i paepur i sig-

urisë së qytetarëve të Vlorës përgjatë Luftës Kombëtare të Vlorës të 1920-ës dhe figurë me përmasa të madha kombëtare. Mëhill Gjeç-Kryeziu është quajtur për 22 vjet, nga lindja e tij më 12.7.1874 deri më 29.6.1896, kur e ka ndryshuar emrin në Shtjefën Kostandin Gjeçovi, pasi përfundoi studimet e larta teologjike në Kreshevë të Dalmacisë dhe në rregjistrat françeskan zhduket emri Hilë Gjeç dhe zëvendësohet me Shtjefën Konstantin Gjeçovi. Faik Konica e ka cilësuar Gjeçovin si, "njeri nga njerëzit më të lartë që ka pasur Shqipëria", ndërsa albanologu austriak Norbert Jokli e ka quajtur, "punëtor i palodhur në fushën e letrave shqipe". Propozime janë bërë dhe për Rustem Rexhep Kabashi, patriot, atdhetar, zemërzjarrtë, sikurse njihet Robin Hudit shqiptar prijës e luftëtar

mitik i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, kryengritës i gjithë epokave, prijës i kryengritjeve të mëdha shqiptare të 1909-1910-ës, në prag të Pavarësisë shqiptare, babai i 14 djemve dhe 5 vajzave, katër herë i burgosur nga osmanët, katër herë i internuar dhe për mosbindje ndaj pushtuesit, i dënuar "me varje në litar" në qendër të Prizrenit, duke ngelur përjetësisht moment atdhetarie dhe përjetësie për truallin arbëror. Xhemal Meçi botoi librin për dëshmorët e Atdheut të nën-prefekturës së Pukës, në kuadrin e 80 vjetorit të çlirimit të Atdheut.

### LIBRA TË SHKRUARA DHE NDERIME

Gjatë viteve Xhemal Meçi ka shkruar dhe botuar mjaft shkrime për historinë dhe gjuhësinë në trevën e

Pukës, të Shkodrës dhe të karakterit kombëtar. Ai ka botuar dhe librat "Kanuni i Lekë Dukagjinit", varianti i Pukës, Itali, 1996; "Ndue Jak Pjetri Mësues i Popullit" (me bashkëautor), Tiranë 1999; "Migjeni në Pukë" (me bashkëautor), Tiranë, 2001; "Kanuni i Lekë Dukagjinit", varianti i Mirditës, Tiranë 2001; "Puka që në lashtësi", Tiranë 2003; "Kabashi" (monografi), Tiranë 2008; "Poeti i Malësisë", Tiranë 2015; "Poeti i Kabashit", Tiranë 2016; "Komani, trashëgimi iliro-arbërore", Shkodër 2019 dhe "Na ka çue Shkodra ni fjalë", Shkodër 2024.

Në jetë Xhemal Meçi shtë nderuar dhe vlerësuar me këto tituj: "Qytetar Nderi i Bashkisë Pukë"; Urdhërin "Naim Frashëri" i argjendte; Urdhërin "Mjeshtër i Madh" dhe çmimin "Virtus".

FOTOREPORTAZH

# 2024 – OBVL REKORD VEPRIMTARISH KUALITATIVE

Gjatë 2024, Organizata e Bashkuar e Veteranëve të LANÇ dhe Pasardhësve përmbylli me sukses programin e veprimtarive, ku më të rëndësishmet qenë:

1. AKADEMIJA PËRKUJTIMORE: “HEROI I POPULLIT DHE NDERI I KOMBIT RRAHMAN PARLLAKU, GJENERALI QË BËRI EPOKË”
2. KREMTIMI I 30 VJETORIT TË OBVL dhe botimi i librit “30 VJET OBVL, HISTORI SUKSESI”
3. KUVENDI i 9-të KOMBËTAR i OBVL qe zgjodhi kryetare Znj. Tatjana Parlaku-Çarkaxhiu...

4. AKADEMIJA PËRKUJTIMORE: “Gjeneral Dali Ndreu, strategu qe drejtoi luftën për çlirimin e Tiranës.

Këto veprimtari të nivelit akademik, të shoquara me dokumentarë televizivë, me referate e kumtesa të qënësishme, të përgatitura dhe mbajtura nga personalitete të njohura të shkencës dhe letrave, u ndoqën me interes të veçantë nga veteranë të LANÇ dhe pasardhës-anëtarë të OBVL, si dhe nga dhjetra të ftuar nga ogranizatrat homologe.

Përgatiti: **Rajmonda MALEÇKA**



Përgatiti: **Rajmonda MALEÇKA**